

**Sesioni Informues mbi Reformën Administrative-Territoriale 2026**  
**12 maj, 2026.**  
**Fier, Shqiperi**

**Minutat e Takimit**

**Valbona Karakaci:**

Përshëndetje, mirë se erdhët në dëgjesën e pestë publike të organizuar nga Komisioni për Reformën Administrative Territoriale. Kënaqësi që të shikojmë një sallë të mbushur plot; në fakt, interesi ka qenë i tillë edhe në katër takimet e tjera. Ky takim do të organizohet sipas disa rregullave të cilat unë do të doja paraprakisht t'ju sillja në vëmendje. Janë tre tema kryesore për të cilat Komisioni është i interesuar që të marrë kryesisht rekomandimet, vlerësimet, sugjerimet tuaja. Ato lidhen me: tema e parë me territorin dhe qeverisjen e tij, tema e dytë me shërbimet, funksionet dhe kompetencat e bashkive, dhe tema e tretë me financat vendore. Duke mirëkuptuar faktin që asnjëra prej këtyre tre akseve nuk mund të funksionojë në mënyrë të mëvetësishme në një reformë, do ju lutesha që t'i përmbahemi këtyre tre akseve edhe për arsye të kohës që do donim t'i dedikonim komenteve tuaja. Secila prej temave do të marrë rreth 30 minuta. Kjo do të thotë që, përsëri një lutje nga ana ime që ndërhyrjet të jenë koncize, në mënyrë që të mund të marrim sa më shumë opinione. Do t'ju luteshim që ndërhyrjet të mos zgjasnin më shumë sesa dy deri në tre minuta, gjë që do të na mundësonte që të merrnim rreth 10 komente, sugjerime për secilën prej temave. Në ndërkohë, duke reflektuar për interesimin shumë të gjerë që tema ka në publik për ata qytetarë të cilët nuk do të mund të marrin fjalën, dhe kjo mund të ndodhë, ju lutem në tavolinë, më falni, në karriget tuaja është një kod, është kodi i faqes së dedikuar të uebit të reformës në faqen e Parlamentit, ku qytetarët, shoqëria civile, sektori privat mund të komunikojnë drejtpërsëdrejti me Parlamentin për të ndarë opinionet dhe sugjerimet. Do të kishim dëshirë që të dëgjonim pikëpamje dhe këndvështrime nga të gjitha bashkitë e Qarkut, kështu që do ju lutesha që t'i japim mundësi diversitetit edhe gjeografik, edhe atij të përfaqësimit. Këto dëgjesa lexohen nga projekti "Bashki të Forta". Unë jam këshilltarja strategjike e projektit, mbështetur nga Qeveria e Zvicrës dhe ajo suedeze. Thënë kjo, më lejoni që t'ia kaloj fjalën për të vendosur kuadrin e përgjithshëm të dëgjesës dy bashkëkryetarëve të Komisionit, zoti Mesniku.

**Arbjan Mazniku:**

Nderuar Kryetar i Bashkisë së Qarkut të Fierit, nderuar deputetë, nderuar miq të cilët keni marrë pjesë në numër në këtë dëgjesë. Siç jeni në dijeni, Komisioni i Reformës ka nisur tashmë dëgjesat në të gjitha qarqet për të diskutuar në lidhje me cila do të jetë e ardhmja e mënyrës se si funksionon pushteti vendor në Shqipëri. Shpeshherë ne kur themi "raporti i qytetarit me shtetin", në fakt pjesa më e madhe e asaj që shumica e njerëzve të thjeshtë, qytetarëve të thjeshtë të vendit, mendojnë kur flasin për ndërveprimin me shtetin, po ta thyesh dhe të bësh një listë, kupton që pjesa më e madhe është ndërveprimi në fakt i tyre me Bashkinë e Qytetit të Kombëtar. Sepse në fakt pushteti vendor është i lidhur ngushtësisht me një mori gjërash të përditshmërisë së jetës së njerëzve, të të gjithë jetës. Që nga momenti që lind, te momenti që shkon në çerdhe e në kopsht, tek momenti që del të luajë te lagjja, te momenti që mbaron shkollën, martohet, fejohe, do të marrë një shtëpi, te momenti që do të rrisë fëmijët e tij, te momenti që do të kujdeset për

prindërit, te momenti që vetë plaket dhe do të dalë diku, deri në momentin e fundit fare madje të jetës, kur njeriun e përcjellin në botën tjetër, prapë jeta e njeriut është e lidhur gjithçkush me Bashkinë. Ndaj dhe tërësia e jetës tonë është e lidhur me mënyrën se si funksionon Bashkia. Ndaj një reformë e tillë padyshim që prek jetën e njerëzve. Ne në vitin 2014 kemi bërë një reformë, unë besoj, të jashtëzakonshme, e cila ia doli me shumë sukses që të konsolidojë nga 373 njësi vendore në 61 bashki, duke i rritur fuqinë ekonomike, duke i dhënë mundësi që të bëjnë më shumë investime në territor, duke i dhënë mundësi që të japin një zhvillim më tërësor territorit dhe me më pak diferenca nga njëri-tjetri, duke i dhënë mundësinë që të kenë më pak borxhe bashkitë, duke i dhënë mundësinë që shumë nga shërbimet që dikur s'ofroheshin fare të kenë mundësi të ofrohen. Dhe tani, pas 10 vjetësh, është një moment i mirë për të bërë një vlerësim të mirë të atyre gjërave që kanë funksionuar, por dhe atyre gjërave që mund të bëhen më mirë, dhe atyre gjërave që mund të rregullohen dhe të sistemohen. Dhe kush janë ato që janë sfidat tona kryesore që ne duam dhe dëgjojmë shqetësimin e njerëzve? Problemi i parë ka të bëjë me eficientësinë, me mundësinë që bashkitë kanë që t'i ofrojnë siç duhet, në cilësinë e duhur dhe në sasinë e duhur funksionet dhe shërbimet e tyre: pastrimin, mirëmbajtjen e shkollave, riparimin e rrugëve, pastrimin e kanaleve kulluese-vaditëse, arsimin parashkollor, mirëmbajtjen e shkollave. Pra, tërësinë e detyrave që Bashkia ka. Si e kanë mundësinë Bashkia për t'iu ofruar këto shërbime? Kanë mjaftueshëm njerëz? E kanë të qartë mjaftueshëm përgjegjësinë dhe kompetencën nga pikëvështrimi ligjor? Kanë mjaftueshëm të ardhura? Si ndahen raportet midis të ardhurave që bashkitë kanë vetë, që mbledhin nga qytetarët e tyre, dhe atyre që i vijnë nga qeveria qendrore? A ia dalin dot të gjitha bashkitë në mënyrë të ngjashme t'i ofrojnë këto shërbime siç duhet për qytetarët e tyre? Ndaj dhe eficientia e ofrimit të funksioneve është sfida më kryesore që duhet të kuptojmë çfarë duhet të bëjmë për ta përmirësuar. Elementi i dytë ka të bëjë me rritjen dhe zhvillimin e territorit të Shqipërisë në mënyrë të ngjashme, kohezive. Ne kemi një seri bashkish të cilat, edhe si rrjedhojë e zhvillimit turistik apo infrastrukturor, janë zhvilluar shumë, kanë ekonomi të fortë, ofrojnë shërbime të mira. Kemi disa bashki që ia dalin ta bëjnë këtë punë pak më pak mirë. Kanë më pak të ardhura, ofrojnë më pak shërbime. Si ia dalim që të kemi bashki të cilat të ofrojnë shërbime në mënyrë më kohezive dhe të kemi zhvillim i cili të krijohet në të gjithë territorin në mënyrë të ngjashme? Ne kemi një sfidë demografike. Është një sfidë e cila ndodh në të gjithë Evropën, por ne duhet ta kuptojmë, ta pranojmë dhe ta shohim që sfida është aty. Ne kemi lëvizjet e njerëzve nga zona periferike drejt qyteteve. Të dhënat e ECS-it na tregojnë që qytetet e mëdha si Fieri, Vlora, Durrësi, Tirana përbëjnë 70% të popullsisë. Pra, ne kemi lëvizjet e njerëzve nga periferia drejt qendrave të mëdha dhe kemi një lëvizje të dytë të njerëzve nga zonat e fshatit drejt zonave urbane. Kjo është një lëvizje e cila është në proces. Çfarë duhet të bëjmë në raport me ofrimin e shërbimeve në ato zona që kanë më pak njerëz dhe ofrimin e shërbimeve në ato zona që bëhen me më shumë njerëz? Si e fuqizojmë Bashkinë për ta përballur këtë sfidë? Dhe ne kemi një sfidë e cila është edhe më e madhe se të gjitha këto bashkë. Në vitin 2027, qeveria shqiptare do të mbylli negociatat me Bashkimin Europian dhe në 2029-ën, nëse gjërat shkojnë siç duhet, Shqipëria do të jetë një vend anëtar i Bashkimit Europian. Në atë moment, 70% e ligjeve dhe rregullave të Bashkimit Europian që ne po negociojmë tani me BE-në, në fakt zbatohen në nivel vendor, zbatohen tek bashkitë apo tek qarqet. Si do bëhen strukturat tona të gatshme për t'i absorbuar këto ndryshime ligjore, por më e rëndësishmja është si do bëhen të gatshme për tërhequr nga Bashkimi Europian financimet e programeve të rëndësishme të BE-së, si Fondit të Kohezionit Social dhe Fonde Strukturore, për të pasur mundësi që të sjellin në

territorin e tyre një zhvillim koheziv. Bashkimi European është një ndër programet më të mëdha që ka, është ai që quhet Programi i Kohezionit Social, programi i cili synon të zhvillojë të gjithë Evropën në mënyrë të ngjashme, por nuk janë para që ato thjesht t'i japin. Janë para të cilat bashkitë, rajonet, territori duhet t'i përhithin me projekte të qarta, me vizion të qartë dhe t'i zbatojnë siç duhet. Kjo kërkon që bashkitë të jenë të afta të mendojnë në këtë mënyrë dhe të kenë burimet e nevojshme njerëzore për ta bërë këtë punë siç duhet. Ndaj të gjitha këto na krijojnë një kuadër të nevojës që ne sot kemi për të vlerësuar nevojën për të bërë një reformë të re, qoftë kjo nga ana e përgjegjësive, kompetencave. Çfarë kompetencash duhet të kenë bashkitë? A duhet t'i kenë më të qarta? A duhet të kenë më shumë? A duhet të kenë ndonjëra që s'duhet ta kenë? Si duhet të funksionojë financimi i bashkive? Çfarë të ardhurash bashkitë duhet të mbledhin vetë? Sa duhet të mbledhin vetë dhe çfarë të ardhurash mund t'i vijjnë nga qeveria qendrore dhe si duhet t'i vijjnë? Dhe sigurisht, e kombinuar me këto dy territore, në cilin territor duhet të qeverisin bashkitë? Sfidat që kemi në këtë element janë dy dhe të rëndësishme. Ku e gjejmë pikëprerjen midis efijencës, bashkive të cilat janë të afta, të forta, që kanë burime njerëzore, që mbledhin të ardhura, që planifikojnë siç duhet, dhe afërsisë me territorin që zëri i çdokujt të dëgjohet në qeverisje? Ku është pikëprerja e duhur midis këtyre dy pikave? Nga njëra anë. Nga ana e dytë, si arrijmë të krijojmë ekonomi shkalle? Do të thotë një bashki që ka mundësi të ketë mjete të mira, të ketë mundësi të ketë inxhinierë, të ketë juristë, të ketë avokatë, por të ruajmë edhe elementet shumë të rëndësishme të identiteteve specifike të një zone të caktuar dhe të kombinojmë këto dy elemente. Ndaj këto janë tema të cilat ne duhet ta bëjmë këtë diskutim bashkë me të gjithë njerëzit, bashkë me ju. Jam shumë i lumtur që në këto dëgjesa ia kemi dalë me shumë sukses që t'i bëjmë të gjitha bashkë, bashkë me opozitën, dhe të bëjmë një diskutim të mirëfilltë i cili duhet të ndikojë mënyrën se si qeveriset Shqipëria, jo në dy, jo në katër, por në 30, 40 apo 50 vitet e ardhshme, dhe se si ia dalim që të kemi një pushtet vendor i cili, siç e thamë në fillim, ia del me sukses si qytetari, si person i lindur e deri në momentin që mbaron jetën, të ketë një derë afër që ka mundësi që t'i ofrojë shërbimet që duan. Faleminderit dhe mezi pres të dëgjojmë të gjithë opinionet e njerëzve.

### **Luciano Boci:**

Faleminderit, të dashur qytetarë të Qarkut të Fierit, nderuar deputetë, drejtues të pushtetit vendor, përfaqësues të organizatave joqeveritare, nderuar pjesëmarrës, kënaqësi që gjendemi bashkë në këtë diskutim, jo bashkë me PS-në, sepse më pëlqen fjala bashkë, por ne jemi tërësisht në pozicione të përcaktuara, qarta, sepse nuk duam të hyjmë në interpretime të tilla politike ku secila palë ka qëndrimet e sakta të veta në raport me një reformë shumë të rëndësishme siç është reforma territoriale. Sot, në fakt, jemi në Qarkun e Fierit, një nga qarqet më të mëdha të Shqipërisë që ka një territor me potencë të madhe demografike, ekonomike, bujqësore, industriale, kulturore dhe historike. Dhe për këtë arsye dhe dëgjesa ka atë rëndësinë e vetë. Madje do të thoja dhe do të shtoja që ka qenë një ndër qarqet që nuk e ka pranuar ndarjen që është bërë në 2014-ën, sepse nga komunitete të vazhdueshme të Qarkut të Fierit ka pasur dhe ka kërkesa që ato të kenë përfaqësimin e tyre në pushtetin lokal, të kenë njësitë e tyre dhe pse jo, mos i kenë. Kërkesa vjen nga Cakrani, vjen nga Levani, vjen nga Dushku, vjen nga Ardenica, vjen nga Fratari dhe janë kërkesa që burojnë nga vetë qytetarët, se tek e fundit këto dëgjesa kanë këtë synim, që ne mendimet tuaja t'i implementojmë në pjesën e konkludimeve të asaj reforme të re e cila duhet të jetë konsensuale. Këtu po pajtohemi me konkluzionin. Ne duhet të kemi një përfundim që

konsideron, së pari, kërkesat e qytetarëve, së dyti, kërkesat e partive politike, përfshirë Partinë Demokratike, partitë e tjera të opozitës, por edhe pjesën e maxhorancës së Partisë Socialiste. Dhe duke qenë të tilla, janë të domosdoshme. Një reformë territoriale nuk mund të realizohet nga qeveria në zyrat e saj, siç është para hedhur teza, dhe nuk mund të jetë një vendim i paracaktuar politik, siç është bërë në fakt, ku janë shuar variante me numër të caktuar bashkish, gjë që nuk është e mirë për klimën e diskutimit tonë. Dhe kjo reformë nuk mund të ndërtohet edhe teknikisht vetëm nga një komision i cili vërtetë ka përbërje politike, ka dhe përbërje ekspertësh, por ekspertët do ta kishin shumë të lehtë të vendosnin ato vijat sipas profesioneve të tyre të nderuara, por nuk do mjaftonte. Dhe unë mendoj që kjo dëgjese është e domosdoshme dhe unë pretendoj që do konsiderohen të gjitha mendimet tuaja dhe që do ndikojnë në rezultatin final të punës së komisionit, të paktën në përgjithësi për atë pjesë të opozitës që unë përfaqësoj në komision. Tani ka një tendosje, ka shumë pyetje në fakt në këtë sallë dhe unë e di shumë mirë që e para që edhe këtu u trajtua dështoi 2014-2015-a. Tani për ta trajtuar këtë çështje duhet të bëjmë një krahasim shumë të thjeshtë, jo me atë çka ishte para 2014-ës, është e gabuar. 2014-2015-a e ka sfidën me vetveten, me pritshmëritë që ndërtoi, me objektivat që ndërtoi dhe atë çka realizoi. Këtu është dështimi apo sukcesi dhe s'mund të themi që në krahasim me 373 ne jemi në një situatë të lumtur kur ata që kanë përvojë politike, përfshirë dhe mua, e dinë shumë mirë që reforma e 2014-ës në një datë para votimit të saj në parlament ishte me 47 njësi vendore dhe mrekullisht brenda 24 orëve u bë me 61 njësi vendore, siç e kemi sot. Pra, qartazi duket që ishte një artifikt, artifikt politik i cili në fakt nuk vizatoi kufij territorial, por kufijtë e votës politike dhe kjo ka qenë një ndër arsyet që PD-ja e ka kundërshtuar vazhdimisht dhe rezultati i kësaj reforme nuk është ai i pritshmi, sepse ne e dimë shumë mirë që kjo reformë ka dështuar në shumë nivele, ka dështuar në nivelin e përfaqësimit. Shumë komunitete sot janë të papërfaqësuar në nivel të qeverisjes vendore, janë larguar nga përfaqësimi, duke u larguar nga përfaqësimi normal, pushteti vendor është larguar nga llogaridhënia. Nuk jep kush llogari më nga pushteti vendor, përndryshe në një moment të caktuar kur llogaridhënia nuk ishte vetëm në nder, por ishte dhe në komunikimin e drejtpërdrejtë që kishte qytetari. Sot kjo reformë ka dështuar në shërbimet e saj. Ka një diferencë shumë të madhe edhe kjo është evidentuar edhe nga studimet e SIGMA-s, një diferencë shumë të madhe midis shërbimeve që ofrohen afër qendrës dhe shërbimeve që ofrohen në zonat rurale, ku disa shërbime pothuajse dhe mungojnë, ku shërbimet që janë nuk janë në standardin minimal të tyre siç duhet të ishin dhe kjo sjell një arsye, një shkak, një pasojë, falni shumë të fortë, dhe pasoja kryesore është largimi i popullsisë nga zonat rurale dhe Fieri, sikurse qarqet e tjera e vuan një gjë të tillë. Dhe kjo pasojë e shpopullimit ka prekur sidomos pjesën e veriut edhe normal që ka dhënë efektet e saj dhe në pjesën e jugut. Shqiptarët vërtetë migrojnë në një pjesë të vogël, por shqyrr që nuk u bë ai krahasimi me Zvicrën në fakt, sepse ai e agravon pastaj edhe vetë krahasimin, e bën me nerva, sepse shumica e shqiptarëve ikin jashtë shtetit dhe ikin jashtë shtetit sepse nuk shohin siguri arsimore që është shërbim, nuk shohin siguri shëndetësore që është shërbim që vjen nga pushteti lokal, nuk shohin siguri sociale që vjen nga pushteti lokal, sikurse punësim, zhvillim ekonomik dhe gjëra të tjera që një pushtet lokal efikas duhet t'i realizonte dhe nuk i realizon as këtu në Fier. Unë sot kam lexuar një statistikë, po dal nga shablloni i fjalimeve ku lindshmëria në Shqipëri ka rënë në shifra negative dhe midis qarqeve ishte dhe Fieri. Në qoftë se ne do kishim migrim nga zonat rurale drejt Fierit, atëherë lindshmëria nuk do kishte rënë, por është emigrim, largim nga zonat rurale përtej Shqipërisë, sepse edhe në Fier ne nuk i kemi të gjitha shërbimet në atë nivel që i kërkojnë qytetarët. Dhe ajo që u po hua këtu dhe është e vërtetë,

po kemi diferenca shumë të mëdha midis bashkive. Bashkitë nuk startuan në mënyrë të barabartë në mbështetjen e tyre financiare. Bashkitë e mëdha kishin më shumë mundësi financiare dhe bashkitë e vogla në atë 61-shin, se edhe ato nuk konsiderohen të vogla, kishin më pak mundësi dhe kjo u thellua në vitet në vazhdim përgjatë këtyre 10 viteve, sepse qeveria qendrore e jona nuk përdor modelin e financimit gjerman që t'i japë para bashkive me qëllim që bashkitë të realizojnë funksionin e tyre për t'i shërbyer qytetarit një përqindje të lartë të produktit të përgjithshëm bruto, por ka qëndruar tek shifra minimale 1%. Ka dështuar reforma në funksionalitet, e thonë të gjithë përfaqësuesit dhe të maxhorancës, sepse funksionet e përcaktuara në ligjin organik të pushtetit vendor nuk janë të qarta, janë 42 në fakt, por nuk ndahet kush funksion i përket pushtetit vendor dhe kush funksion i përket pushtetit lokal. Ka dështuar në kompetenca, sepse u përcaktuan disa funksione, por nuk u përcaktuan mjetet dhe kompetencat janë marrë sot nga ndërhyrjet e pushtetit qendror. Listohen më shumë se 7 ligje sektoriale, të cilat godasin drejtpërdrejt autonominë vendore dhe sot ka dështuar edhe në demokracinë e brendshme të vetë pushtetit lokal. Është demokraci e rrënuar dhe duke ditur këtë dështim, patjetër është ky dështim që na ka sjellë këtu dhe në radhë të parë është kërkesa e qytetarëve, ajo që na imponon që ne të bëjmë një dëgjese. Nuk është, kam thënë dhe në takimet e tjera, nuk është se e kanë kërkuar kryetarët e bashkive dhe e kanë ngritur zërin se s'kanë funksione të qarta, se s'kanë kompetenca, se s'kanë autonomi financiare, sepse edhe këtu dështimi është shumë i madh në autonomi financiare. Jo, nuk është as kërkesa e Bashkimit Evropian. Sot kryenegociatorja e ka shprehur qartë sfida kryesore, sipas saj, në fakt është e shënuar në kërkesat kryesore që imponon BE-ja për Shqipërinë, për të hyrë në Europë, është mjedisi, krahas mjedisit, është korrupsioni, është raporti ndërmjet parlamentit dhe ekzekutivit, është çështja e administratës dhe çështja e menaxhimit të mbetjeve që futet tek mjedisi, por nuk është pushteti vendor. Edhe në formatin që e kemi ne sot, mund të jemi shumë të pranueshëm në BE, sepse përafrimi i 70% i legjislacionit që prek pushtetin vendor është krejtësisht i barabartë me legjislacionin, me kuadrin ligjor evropian dhe ne këtë duhet ta pranojmë. Ajo, në fakt, që ekziston sot në Shqipëri është që ekziston dhe në këtë sallë tensioni territorial, ka tension territorial. Njerëzit duan të riformatojnë territorin, sepse duan bashki të forta, duan të riformatojnë territorin, sepse duan funksione të qarta, duan të riformatojnë territorin, sepse duan kompetenca të qarta dhe duan autonomi financiare të prekshme dhe të realizueshme. Ka tension, sepse ndarja e 2014-ës ishte politike, ka tension, se në fakt opozita atëherë u largua, por sepse nuk ju dha vetoja në parlament, por u la thjesht me votimin me variante që s'duhet të ndodhi në këtë komision dhe ka tension, sepse janë hedhur ato ide që unë i parashtrova që në fakt bllokojnë edhe pak diskutimin tonë. Janë ato variantet që synojnë dhe kërkojnë uljen e numrit të bashkive, qoftë këtu në Fier, por edhe në gjithë territorin e Shqipërisë. Bashkitë e mëdha rriten territorin, mund ta rrisin territorin, por kanë zvogëluar qytetarin, kanë larguar qytetarin, kanë humbur përfaqësimin dhe kanë sfumuar demokracinë vendore. Prandaj, dashur miq, unë kërkoj nga ju që mendimet tuaja të jenë në raport vetëm me një fokus, jo me raportin siç ka qenë tani pushteti vendor, jo në raport me politikën, jo sipas mendimit. Duhet ta kapërcejmë këtë gjë që pushteti lokal është magazinë votash për pushtetin qendror. Kush ka pushtetin lokal, ka pushtetin qendror. Jo, sot s'duhet të flasim fare për pushtetin, sot duhet të flasim për qytetarin. Do pak guxim, nuk do lavdërim administrative, por do sinçeritet dhe guxim që në fund ne t'i japim shqiptarëve kudo ku janë, që në fakt afektohen shërbimet e tyre në çdo stad të jetës, pushtet real vendor që i shërben totalisht

jetës, përmirësimit të jetës së tyre dhe dëshirës së tyre për të qëndruar në territoret ku ato banojnë. Faleminderit.

### **Valbona Karakaci:**

Faleminderit për të dhënë edhe modelin. Dëshironi ta rimerrni fjalën? Janë 4 minuta diferencë. Jo, nuk ka problem, duan të dëgjojnë njerëzit. Ndërkohë, ju e shikoni që është një minutazh, një ekran. Hapim seancën e dëgjuesës me tematikën e parë që lidhet me territorin dhe qeverisjen. Reforma e viteve 2014, në fakt e përfunduar në vitin 2017, krijoi bashki më të mëdha. A do të kishim modele të cilat do të mund të përfaqësonin më mirë qytetarët, ulnin pabarazitë në territor, ofronin shërbime më efikase? Këto modele a mund të mendohen brenda një modeli të ri qeverisje që lidhet me rajonet, me qarqet, me fuqizimin e njësive administrative, me bashki të natyrave më diverse, rurale, malore? Këto janë disa nga temat për të cilat komisioni do kishte interes të dëgjonte komentet dhe reflektimet tuaja. Fjala për ju. Do ju lutesha që të prezantoheshit fillimisht dhe nëse është e mundur, ju lutem edhe zonën nga vini, në mënyrë që të sigurojmë pak edhe këtë gjeografinë. Zotëria dhe pastaj një zotëri... Zotëri atje, po, ju lutem se kemi... salla është pak e madhe. Zotëria dhe zotëria atje, ju lutem përgatisni mikrofonat. Faleminderit.

### **Yzalien Hoxha:**

Unë jam Yzalien Hoxha, administrator publik, ish-administrator publik, ekonomist në financat publike dhe studiues i shkencave sociale. Jam autori i 4 librave në fushën e administrimit publik: "Pushteti vendor dhe vetëqeverisja lokale", "Tiranë 2004", "Bashkia dhe Kodi i Drejtimit 2007", "Inteligjenca, politika dhe pushteti: si ta performojmë kohën me inteligjencë në 2017" dhe librin e fundit "Demokracia si e mirë publike: anatomia e pushtetit 2023". Por kam qenë koordinator i reformës administrative territoriale të Shqipërisë 2014-2017. Kështu që edhe sot ndjej një përgjegjësi të madhe kur diskutohet për dhe flitet për administrimin publik, sepse administrimi publik është bërë shtëpia ime. Për arsye sepse shkenca e administrimit publik ka të vetmin instrument që për të reformuar pushtetin vendor, natyrisht është reforma administrative territoriale dhe pastaj veprojnë instrumentet e decentralizimit demokratik, 3 reformat e tjera, pra reforma në shërbimet publike, reforma në financat publike dhe reforma administrative, pra përmirësimi dhe veprimi i kapaciteteve tekniko-administrative përkundrejt zbatimit të kodit të drejtimit. Ne jemi i vetmi vend që nuk kemi kod të drejtimit të pushtetit vendor, që Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale e ka kërkuar qysh herët që edhe fill pas reformës 2014-2017, kodi i drejtimit të instalohet në pushtetin tonë vendor. Prandaj unë do të flas në mënyrë të drejtpërdrejtë, por mund t'ju duket se mund të mbroj. Edhe 1 minutë, ju lutem. Po, mund të mbroj edhe rezultatet e reformës administrative territoriale 2014-2017, por jo, unë kam ngulur nëse politika që nga viti 2013 edhe në vazhdim gjithmonë e ka trajtuar çështjen e reformës politikisht. Ajo reformë u bë që nga fillimi deri në fund, duke zbatuar faktorët e ndërtimit të saj dhe kriteret teknike shkencore të ndërtimit strukturor të njësive të qeverisjes vendore, të cilët janë faktorët: gjeografia e vendit. Së dyti, madhësia, shpërndarja dhe përbërja e popullsisë etnike, kulturore, sociale dhe fetare. Dhe së treti, niveli i zhvillimit ekonomik, premisat e zhvillimit që krijojnë hapësira rurale dhe zona urbane dhe industriale të përqendruar. Dhe menjëherë pastaj zbatohen... neve zbatuan kriteret, kriteret teknike shkencore të administrimit publik. Të cilët janë? Të cilët janë? Do t'ju lutem, të cilët janë? Që t'u japim mundësinë të gjithëve që të flasin, ju lutem. Të cilët janë? Duhet ta përmbyllni, po. Pra, kriteri i gjeografik i territorit, pra shtrirja e territorit, kriteri demografik i popullsisë, madhësia

dhe përbërja e popullsisë, kriteri ekonomik, burimet ekonomike, matja dhe vlerësimi i tyre. Kriteri politik, politika si instrument për të zgjidhur problemet që kryqëzojnë jetën e njerëzve dhe jo për t'i krijuar. Ju faleminderit, besoj që duhet ta përmbyllim. Jeni 4 minuta, në mënyrë që të kemi mundësi. Okej. Prandaj, si deputet, i veprimit të këtyre faktorëve, i këtyre kriterëve duhet domosdoshmërisht, duhet domosdoshmërisht që edhe në këtë riorganizim të ri të kihet parasysh gjithmonë, gjithmonë aspekti i zbatimit të faktorëve dhe të kriterëve përkatëse. Ju faleminderit për të krijuar një bashki aq të madhe sa të jetë demokratike dhe aq të vogël sa të jetë funksionale dhe efektive. Faleminderit. Dhe, dhe, dhe këtu, dhe këtu...

#### **Valbona Karakaci:**

Ju, ju faleminderit. Ëh, jo, ju lutem, do duhet të respektojmë kohën. Jeni dy minuta me zotëria. Jo, ju lutem. Jo, ju lutem, do ta merrni në seancat e tjera. Okej, po, përmbyllini.

#### **Yzalien Hoxha:**

Dhe fundit, kur flitet për sasinë e bashkive, njësitë të qeverisjes vendore në Shqipëri, a jep 100? A 36? Ai kthehemi përsëri te komunat. Natyrisht, natyrisht, kjo të vret mendjen për arsye sepse vepron, vepron parimi i keq: atje ku votohet për mua të ketë bashki, atje ku nuk votohet për mua të mos ketë bashki. Kjo është katastrofa e pushtetit vendor në Shqipëri nëse do të zbatohet në mënyrë të tillë.

#### **Arben Nyzeqari:**

Ju faleminderit, zotëria. Dhe pastaj Vladimiri atje. Po, zotëria. Po, ju lutem, pastaj zotëria tek radha e tretë. Faleminderit për mundësinë që na jepni në këtë bashkëbisedim të parashtrimit. A mund të prezantoheni, ju lutem, edhe nga vini? Po, do prezantohem për mundësinë që na jepni lidhur me shërbimet e pushtetit vendor.

Unë quhem Arben Nyzeqari, jam lindur dhe rritur në qytetin e Fierit, me përjashtim të tetë viteve që kam qenë pesë vite student në Tiranë, '83-'88, dhe tre vite emigrant në Greqi. E bëra këtë parantezë sepse, ëh, si të gjithë të tjerët, unë ngrita një biznes këtu në qytetin e Fierit dhe këtë diskutim unë dua ta lidh pikërisht me shërbimet e bashkisë së Fierit, që me thënë të drejtën, unë si qytetar pa dashur fare të bëj asnjë lloj politike, se jemi të lodhur nga politika, bashkia e Fierit për mua sot është kthyer në bashkinë e Fierit, një ferr që ne nuk e meritojmë. Pse e them këtë? Organi i bashkisë është një nga organet kryesore që ishte për procesin e legalizimit, i cili ka filluar me ligjin e vitit 2006. Por unë procesin e legalizimit e kam filluar me bashkinë Fier dhe ka 20 vjet që bashkia Fier nuk më ka ofruar absolutisht asnjë shërbim. Përkundrazi, më ka futur në konflikte të pamërituar për mos të thënë me mafjen e tokave, sepse themi për territorin. Pra, fuqia e bashkisë nuk konsiderohet në atë që, ëh, është kryetar i bashkisë apo është këshilli bashkiak dhe duhet të veprojnë në kundërshtim me kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet të cilat përcaktojnë funksionet e kësaj bashkie. Janë këto që janë të përcaktuara edhe në ligjin 139 të vitit 2015 për funksionin e vetëqeverisjes vendore dhe janë shumë parime që nga kjo bashki, pikërisht për rastin tim, janë shkelur si parimi i përgjegjshmërisë, parimi i transparencës e shumë parime të tjera që janë të përcaktuara dhe në kodin e procedurës administrative. Pra, duhet të kemi parasysh, të dalim tek zoti Mazniku, që të bëjmë një reformë territoriale në të ardhmen, duhet të dimë çfarë kishte reforma territoriale e mëparshme që nuk shkuan mirë. Bashkia nuk duhet që me këtë administratë të veprojnë në mënyrë arrogante me qytetarin. Ndërkohë, dhe unë

do ta përfundoj, jam një qytetar që në vitin 2011 kam dhënë taksën e infrastrukturës për bashkinë Fier dhe 20% të vlerës së truallit që kam blerë nga shteti, 113 milionë lekë, dhe 20% që i administrohet në buxhetin e bashkisë. Dhe doni ta dini, të nderuar, në përgjigjen që më jep bashkia në vitin 2022, më thotë që nuk kemi informacion. Atëherë, ku është menaxhimi i taksave të qytetarëve? Ku është menaxhimi i të gjithë atyre ardhurave që futen në buxhetin e shtetit që unë, si qytetar, me mundimin, bashkë me vëllanë, punova në Greqi dhe sot aty është hapur një gropë? E keni 100 m larg, se unë jam një qytetar. Ju thashë edhe njëherë tjetër, jam rritur dhe e mbylla, e mbylla, jam rritur dhe e kam shtëpinë 500 m, jo më shumë se 500 m larg nga bashkia Fier dhe nuk marr shërbime nga kjo bashki. Përkundrazi, më ka futur në konflikte të tilla që më ka rrezikuar edhe jetën. Prandaj, meqë kryetari i bashkisë është këtu, le të hapi zyrat e bashkisë, sepse i kam vajtur dhe me gazetarë dhe nuk ka pranuar që të japë sqarime lidhur me krimet që ka bërë mua dhe familjes time, por edhe shtetit të saj. Ju faleminderit.

### **Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit, zotëria, dhe pastaj zonja, zonja atje. Po, ëh, ju lutem, nëse mund të fokusohemi tek tema, do të ishte shumë mirë. Qeverisja është tema dhe territori.

### **Vladimir Gorçari:**

Po, ju përsëndes. Quhem Vladimir Gorçari, njëse administrative të sakra. Kam patur fatin që të qeveris në Cakra në tetë vjet dhe kam qenë dhe anëtar i komisionit të reformës territoriale në 2014, si kryetar komune, që isha në Cakra, dhe sot ndihem mirë përsëri që vij dhe jap kontributin tim në drejtim të reformës territoriale dhe në ndihmë të qytetarëve. Gjatë qeverisjes time, ose gjatë pushtetit që ka qëndruar sa më afër, sa më afër qytetarëve, në Cakra janë bërë gati 35 km rrugë asfalt dhe njerëzit që ishin në Fier u kthyen në fshat ku investuan që mbollën ullinj. Nga 80.000 rrënjë ullinj të trashëguara, deri në 2014 janë mbjellë 400.000 rrënjë ullinj, sepse shërbimet u rritën ndaj qytetarit, ndaj fshatarit, po them ndaj fshatarit, shumë nga tiranët që nuk i llogarisnin dhe shpenzimet vinin mbillnin ullinj. U sot në Cakra, nga ajo punë që u bë atëherë, janë 13 fabrika vaji. Çfarë dua të them me këtë? Dua të them dhe një gjë tjetër. Grantet e qeverisë ishin 400 milionë për 17.000 banorë për 84 km<sup>2</sup> dhe 200 milionë lekë të vjetra ishin të ardhura nga taksat. 600 milionë lekë për Cakranjotët. Për 10 vjet shkojnë 6 miliardë lekë. Unë dua t'u pyes qeverinë vendore të Cakrës, jo Armando, sa investime bëhet sot në Cakra për 10 vjet? Më thotë ndonjëri, ka ndonjë nga Cakra këtu? Atëherë po të them unë, është bërë sheditoreja e Cakrës, diçka 500 milionë me hamendje, edhe 2 km rrugë asfalt, nja 200 milionë, gati 700 milionë. Ja po them dhe 1 miliardë. Po 5 miliardë lekë të vjetra ku shkuan? Erdhën në Fier. Shumë mirë që erdhën në Fier, por kjo bëri që një fshat në Gorishovë me 2.000 banorë sot nuk ka shkollë nëntëvjeçare, sepse e iku shërbimet, i iku vota, sepse isha detyruar të shkoja në mesnatë në vdekje dhe në leri në Cakra. Do t'ju jap dhe një shembull tjetër. Kisha 22 banorë që i trajtoja me ndihmë ekonomike. Mirrin, 30.000 lekë të vjetra deri në 40.000 lekë të vjetra, sa aq ishte atëherë. Njërin e kisha njeriu, e kisha personin tim, edhe i thashë: "Nuk do të jap më ndihmën ekonomike, se po i bie shkurt." Ia mbolla tokën ullinj dhe ai sot merr 80 kuitarë ullinj atje dhe më jep kafe ditë për ditë. Ku mund të arrijë kryetari i bashkisë së Fier të t'i hallet e njëjti libofsh në Cakra apo në Levan? Kështu që mendoj që shërbimet duhet të shkojnë sa më pranë qytetarëve dhe reformën territoriale e mendoj të dështuar. Po, ju zoti Mazniku, ne jemi të gjithë shqiptarë, të gjithë jemi kushërinj të tretur, miq e shokë jemi. Të marrit e të djathtë, çojeni shërbimet sa më afër qytetarëve,

të kthehen nga Gjermania, se janë shërbëtorë të Gjermanisë, të kthehen nga Greqia, të kthehen nga Italia dhe të ndërtojmë jetën në Shqipëri. Si ti dhe unë do të na vijë mirë, në qoftë se, në qoftë se, edhe një sekondë, në qoftë se ne do ta çojmë shërbimin atje në fshat, ne do të jemi më të pranueshëm, më të gëzuar, më të lumtur, por dhe më të pasur, se kur të vish në Cakra do të japësh 5 kg ullinj atje, ashtu 5 kg vaj, sepse ka plot. Kurse sot ne u plakëm, në fshat nuk gjen më njeri dhe ullinj të që mbollëm në 2013 dhe në 2007, po ja fëra. Respekte. Dëshiroj që reforma territoriale të ndryshojë dhe numri të rritet.

**Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit, ëh, zonja dhe zonja, dhe po, ju lutem, zonja dhe pastaj zotëria. Zonja, po.

**Elda Goxhaj:**

Përshëndetje të gjithëve. Quhem Elda Goxhaj. Vij nga Patosi. Prej 15 vitesh jam me një kontribut në administratën publike, në jetën publike dhe në administratën publike në atë qytet. E përshëndes punën e komisionit. E vlerësoj edhe hapësirën që i jepni zërit qytetar. Është një detyrë në këtë kontekst ku ndodhet sot Shqipëria, që na lë një detyrë shumë e madhe, ku integrimi europian sot për sot kryeson agjendën e qeverisë shqiptare. Detyrat e shtëpisë i kemi të gjithë për të bërë. Ëh, për shkak të detyrës, unë e kam ndjekur reformën e 2015-s, por ne nuk mund të heqim paralelizma, se po shoh që hiqen paralelizma dhe anatemohe ai proces. Reforma e 2015-s është zhvilluar në një kontekst krejt tjetër, me objektiva të tjera, me një kontekst tjetër dhe me rezultate të tjera të pritshme, ndërsa reforma sot, ëh, zhvillohet në një kontekst krejt tjetër, ku Shqipëria aderon të bëhet pjesë e Bashkimit Europian dhe ne jemi të detyruar që të ecim në kuadër të këtij procesi. Nisur nga, ëh, opinionet publike, por edhe nga disa shprehje të vetë anëtarëve të komisionit, ku gjithë kohës bashkitë e vogla fliten për qëndrime që nuk kanë kapacitete, mas Armando, nuk kanë kapacitete apo nuk performojnë mirë. Më lejoni që, në respekt të qytetarëve që përfitojnë shërbime nga bashkitë e vogla dhe në respekt të gjithë kolegëve që punojnë në bashkitë e vogla, të ndaj praktikë të mira, të paktën të bashkisë së Patos, ku pas reformës territoriale, bashkia e Patos ka një performancë të lartë ekonomike. Është bashki pa borxhe, ka mbuluar gjithë territorin me investime, është vlerësuar gjithmonë me tregues pozitiv. Por dhe një element tjetër që doja ta ndaja patjetër, meqënëse po flasim për integrimin europian, ku rritja e evidentimit, rritja e kapaciteteve dhe përthithja e fondeve është shumë e rëndësishme, bashkia e Patos, krahasimisht edhe me bashki të mëdha, ka arritur të përthithë fonde dhe të zgjerojë hartën e investimeve. Për të dyja këto elementë, që mendoj që janë shumë të rëndësishme dhe janë përmendur gjerësisht në opinionet dhe në vlerësimet publike, dëshiroj të adresoj qëndrimin tim që kushtëzimi territorial mos të ketë këtë peshë kaq të madhe, por të jetë më i orientuar drejt një rikonceptimi i shërbimesh dhe absolutisht që ne mund të shkojmë drejt bashkive më të forta. Shumë faleminderit për hapësirën që na keni dhënë sot si qytetare e këtij vendi dhe nesër si qytetare europiane. Është shumë e rëndësishme që në këtë proces të fitojë Shqipëria. Suksese të gjithëve. Faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Po, zotëria, ju lutem.

**Vangjel Ndreka:**

Përshëndetje. Vangjel Ndreka jam, pensionist. Në lidhje me reformën që po diskutojmë sot, unë mendoj se, duke i rënë dhe shkurt, siç tha, siç u tha dhe këtu, mendoj që reforma e 2015-s ka qenë rezultative duke krahasuar me vitet e mëparshme. Pse them ka qenë rezultative? Do të flas në lidhje me fushën e investimeve që, me këtë ndarje, me ndarjen territoriale që është bërë mbas vitit 2015, duke marrë parasysh bashkinë e Fierit, do të thosha që janë bërë shumë investime në infrastrukturën e njëësive administrative, ku para kësaj reforme ato ishin zero, sepse çdo njësi administrative nuk kishte mundësi financiare. Jo se s'donin të bënin, por nuk kishte mundësi financiare. Në fushën e bujqësisë ka një ndryshim si dita me natën, sepse të gjithë kanalet pastruese ose sistemi i bonifikimit ka ndryshuar, jo vetëm këtu në bashkinë e Fierit, por në bashkinë e Lushnjes, të gjitha, sepse ekziston mundësia e investimit, e shritur efektiviteti i shpenzimeve dhe nëpërmjet këtyre shërbimeve, nëpërmjet këtyre investimeve që është bërë për infrastrukturën e bujqësisë, për infrastrukturën rrugore, për të gjitha, për ndryshimet që janë, si të thuash, në në në në sistemin e transportit, janë janë shërbime që i vijnë në mënyrë indirekte qytetarit. Prandaj do të thosha që të gjitha ndryshimet që janë bërë, unë jam plotësisht dakord me reformën e 2015-s dhe pse po mos vëmë dhe më tej, duke patur parasysh këto probleme, sepse sot që diskutojmë, kanalet vaditëse, kanalet kulluese, kanalet, si të them unë, të qarkullimit të të të sistemit uxor ishin gati 30 apo 40 vjet pa pastruar. Po të vish sot në Fier, të gjithë kanalet janë të pastruara dhe ke qejf t'i shikosh. Pra, këto janë ndihmë që i ka ardhur qytetarit atje dhe kështu duhet ta shikojmë problemin, sepse sa më sa më efektive të jetë njësi administrative, aq më tepër është efektiviteti i shpenzimeve dhe rritet niveli i shërbimit. Po kështu edhe përsa i përket mbetjeve urbane, të gjitha njësitë administrative, mbetjet urbane i mbanin, si të them, unë këtu nëpër rrugë, ndërsa po të vesh sot, ato, siç janë qytetet, grumbullohen, transportohen dhe vënë në fushën e mbetjeve urbane. Ju faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Faleminderit. Po, po, në radhën e dytë, lutem. Po, mikrofoni, ëh, dhe një zonjë. Kemi një zonjë? Okej, okej. Po, përshëndetje.

**Kujtim Cakrani:**

Me radhë, përshëndetje të gjithëve. Do kemi mundësi. Po, unë jam Kujtim Cakrani. Ëh, pa dyshim që mbiemri jam nga Cakrani. Ëh, nuk e fsheh fare faktin që jam sot këtu vetëm për një propozim, që Cakrani duhet të bëhet bashki. Jo vetëm sepse, sepse, sepse kryetari, ish-kryetari i komunës, e propozoi, por do të kuptoni diçka: pa Cakran, nuk ka Fier. Pa Cakran, nuk ka Malakastër. Cakrani është identitet. Cakrani, kur ka qenë, shiko dëgjo, dëgjoni, kur ka qenë Cakrani, dëgjo, o o ti, juve që nuk kuptoni dot, se jeni injorantë, jeni injorantë, nuk kuptoni dot, është problemi që juaj.

**Valbona Karakaci:**

Po pra, zoti Kujtim, ju lutem,

**Kujtim Cakrani:**

problemi, problemi është i këtyre. Tani, kur nuk, kur shikoni, duhet të kuptoni diçka: historia nuk fillon sot, as në 2045-ën, as në 13, 2013-ën. Historia është këtu. Cakrani është identiteti kombëtar. Duhet ta kuptoni këtë gjë: që të bëhet një reformë administrative, duhet të merret parasysh

historia. Historia. Okej, dhe pse historia është këtu dhe askush nga ju nuk e dini çfarë do të thotë histori, sepse Cakrani ka quhej që në kohën e perandorisë osmane Republika e Cakranit dhe ka pasur një arsye pse. Sepse, sepse, sepse, sepse, Cakrani, Cakrani, sot që ne po flasim, janë krahinat më të pasura nga pikëpamja ekonomike dhe ku shkojnë të gjitha këto burime natyrore, natyrore që ka, ka Cakrani? Kalon lumi Vjosa aty dhe sot qytetet më të mrekullueshme të Europës, që këta me paratë e vjedhura të korrupsionit shkojnë i vizitojnë, këta, këta shkojnë i vizitojnë, na mburren dhe na bëjnë foto dhe ai lumi Vjosa që sot është parakombëtar është në Cakran. E dini apo s'e dini? Dhe Cakrani, Cakrani, Cakrani, dëgjo, dëgjoni, dëgjoni, unë se unë e kuptoj, shiko, unë e kuptoj që janë, unë e kuptoj që këta, këta nuk.

**Valbona Karakaci:**

Ju lutem, fokusohuni tek argumentat.

**Kujtim Cakrani:**

Më lejoni të flas, se unë si llogaris fare dhe atë çfarë thoni. Ju lutem, fokusohuni te argumentat. Problemi është që unë jam këtu për t'u thënë dhe të gjithë atyre që nëse duan të bëjnë një reformë territoriale, funksionale, identitare, historike, gjeografike, pa dyshim do të merren të bazë të gjithë faktorët. Faktori kryesor, pa dyshim, që është faktori gjeografik, është faktori ekonomik, është dhe faktori historik. Më thoni mua ju çfarë historie ka Roskoveci. Ma thoni ju çfarë historie ka.

**Valbona Karakaci:Valbona:**

Ju lutem,

**Kujtim Cakrani:**

çfarë historie ka. Po më falni,

**Valbona Karakaci:**

ju lutem, ju lutem,

**Kujtim Cakrani:**

çfarë historie ka. Ju lutem, çfarë historie. Faleminderit. Jo, jo, jo, po se ka mbaruar, ja kohën kur e kenë. Jo, jo, tani unë nuk kam. Do kemi mundësi të gjithë. Ju lutem, dua kohë, dua kohë.

**Valbona Karakaci:**

Ju lutem, edhe 20 sekonda.

**Kujtim Cakrani:**

Jo, s'është 20, se po ju po më prisni fjalën. Ju lutem, këta, këta nuk durojnë dot. E kupton se këta presin fjalën.

**Valbona Karakaci:**

Përmbylleni.

**Kujtim Cakrani:**

Tani unë e kuptoj që jam tip rebeli dhe këta s'e pranojnë dot, po problemi qëndron që këta kështu janë. E kupton? Nuk kam çfarë të bëj. Ja, ja e kuptoni ja kush janë. Ja grupi, se kjo është banda e hajdutëve këtej.

**Valbona Karakaci:**

Fjalja e fundit, ju lutem.

**Kujtim Cakrani:**

Ju lutem, pra më lini të flas, më lini të flas. Këto është e gjitha. Nëse ju, ju nuk e kuptoni çfarë do të thotë Cakrani, problemi është i juaj, nuk është i imi. Prandaj dhe njëherë, zoti Boçi, unë e kuptoj që ju doni të zgjeroni shërbimet, doni të zgjeroni gjeografikisht, historikisht dhe t'i jepni një pamje tjetër Shqipërisë. Dhe s'është e vërtetë fakti që Bashkimi European ne na kërkoi, na kërkoka reformën territoriale për ta pranuar. Bashkimi European ka vetëm një, vetëm një kusht. Fjalja e fundit, ju lutem. Vetëm një kusht ka Bashkimi European që këta mos të vjedhin. Ja kaq ka. Ky është kusht. Ju e përmbyllen. Faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Faleminderit. Ëh, zonja e ka kërkuar fjalën dhe do i japim edhe një, dhe zotëria. Po, ju lutem, zonja. Po, zonja. Po, përshëndetje.

**Lindita Hoxha:**

Quhem Lindita Hoxha. Vij nga shoqëria civile dhe përfaqësoj personat me aftësi të kufizuar. Ëh, në jetën e përditshme jam mësuese. Ëh, për katër vjet rresht unë kam qenë këshilltare në Këshillin Bashkiak të Qytetit të Fierit dhe kam dhe dua të di reforma çfarë roli luan reforma territoriale në lidhje për bashkëpunimin midis këshilltarëve dhe qytetarëve. Përse po e bëj këtë pyetje? Po e bëj këtë pyetje sepse në kohën që jemi në fushatë, shumë këshilltarë bëjnë një theks me premtime dhe në momentin që ulen në karrigen e këshillës, harrojnë këshilltarët, harrojnë se për qytetarin, harrojnë problematikat që kanë, harrojnë gjithçka. Dhe ne si qytetarë na duhet t'u drejtohemi jo këshilltarëve, po t'u drejtohemi deputetëve. Përse duhet t'i drejtohemi deputetëve në kohë që ne kemi këshilltarët? A duhet të ndryshojë roli i këshilltarit në lidhje me marrëdhënien me qytetarin? A duhet të ketë përgjegjësi këshilltari në vendimmarrjet që merr? Unë them se po, sepse ka shumë vendime që merr në favor të bashkisë dhe jo në interes të qytetarit. Ka vendime ku qytetari nuk i dëgjohet fjala, këshilltari nuk i interesohet qytetari. Vij nga fusha e aftësisë së kufizuar. Jam person me aftësi të kufizuar dhe dua të di reforma territoriale a përfshin paketat sociale? Me fjalë, si do të integrohen paketat sociale në reformën që do të bëhet? Pyetja e dytë. Ëh. Zonjë, më fal edhe për qartësimin e të gjithë audiencës. Po miq, që më dha fjala, e di. Po miq, që më dha fjala, nuk seanca nuk parakupton që të merrni përgjigje tani, por mund t'i ngrini këto pyetje. Faleminderit. Vetëm pyetjet. Pyetja e dytë: çfarë masash konkrete parashikon reforma territoriale për përmirësimin e shërbimeve ndaj grupeve vulnerabël? A do ketë ngritje qendrash? A do të ketë ngritje qendrash për personat me aftësi të kufizuara, për moshën e tretë, për të rinjtë që kanë probleme të ndryshme, për gratë e dhunuara? Shpesh e kemi kërkuar ngritjen e një qendre komunitare ku të gjithë këto, me fjalë, grupet e përmendura më sipër të kishin një shërbim sa më të afërt. Edhe një pyetje të fundit dua t'ju drejtoj: a mendoni se nga reforma

territoriale do të krijohet një buxhet ku të ketë për integrimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara? Përse e kërkoj përsëri, përsëri këtë pyetje? Sepse personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një përqindje goxha të madhe në shoqërinë shqiptare dhe janë këta persona, kjo shoqëri që nuk gjen me një fjalë, nuk merr pjesë në ligjëbërjen ose nuk u merret parasysh ose nuk janë pjesëmarrës, më falni, në vendimmarrje si në këshill, në parlament dhe shpesh ligjet që merren për personat me aftësi të kufizuara janë ligje që janë shumë të pakta, janë ligje shumë të pakta, por dhe këto ligje që janë kanë hapësira dhe interpretimi i tyre bëhet në mënyra të ndryshme. Por si do të integrohen personat me aftësi të kufizuara në shoqëri në qoftë se ne nuk i punësojmë, në qoftë se ne i heqim nga puna? A duhet të ketë një plan social për këtë grup që unë përfaqësoj? Ju falenderoj.

### **Valbona Karakaci:**

Faleminderit, zotëria, dhe pastaj zotëria, zotëri atje. Po, ju lutem, do flisni të gjithë, zotëria, dhe pastaj zotëri atje. Po, faleminderit.

### **Idajet Beqiri:**

E vlerësojmë shumë këtë dëgjës. Do jua japim të gjithëve. Po, e vlerësojmë shumë këtë dëgjës. Në emrin e komunitetit Malakastriot do t'ju flasi kryetari i shoqatës Malakastra që jam. Mbase morëm ftesën, bëjmë dhe një konsultë dhe këto mendime nuk janë personale, por janë të komunitetit. Ëh, vlerësoj frymën e kësaj, ë, e këtyre, e këtij komisioni, sepse shohim që sikur ka një avancim në krahasim edhe me të tjerat. Ëh, në radhë të parë ne e vlerësojmë reformën e 2015-s edhe themi që ka rritjet me të vërtetë serioze, por ka vend për përmirësim. Dhe unë nuk do ta konsideroja këtë një reformë të re, por do thoshja që të përmirësojmë ato gjëra që nuk kanë dhënë efektin e duhur. Dhe nëse do ta shikoni me këtë sy, atëherë cilat do të ishin disa nga rekomandimet që bëjmë? Disa nga rekomandimet që bëjmë është e para, ne vlerësojmë që siç po bëni këtë dëgjese me komunitetet edhe me shoqata e tjera, do vlerësoja shumë që të bëni një dëgjese vetëm me historianë dhe gjeografë nga më të mirët e Shqipërisë. Pra, t'i merrni dhe të bisedoni me ta si kanë qenë krahinat tona edhe pse ka patur, domethënë, një ndarje etnokulturore të tillë. Bie fjala Malakastra dhe nëse do të thelloheni në të, jam i bindur pastaj që do të mbërrini në disa konkluzione dhe ato konkluzione do të çojnë në atë që nuk do mendohet thjesht dhe vetëm se çfarë voton një fshat e çfarë voton tjetri, edhe pastaj çoje këtë fshat me filan bashki, sepse kemi pak vota andeja, edhe të rregullojmë votat këteja. Pra, kësaj do t'i jepet fund kësaj praktike. Edhe në këtë aspekt doja të thoshja, bie fjala, krahina e Malakastrës, duam s'duam ta pranojmë, është një krahinë sot invalide. Është një invaliditet. Pse? Ka patur 74 fshatra, sot ka vetëm 41. Dhe jo vetëm ka 41, por në rast e Malakastrës, ti i heq, bie fjala, Cakranin, 11 fshatrat e Cakranit, nuk është Malakastër, quhet Malakastër. Në rast i heq ato fshatrat që kanë Berat apo edhe një që i ka marrë Tepelena, nuk është Malakastër. Mirëpo, Gjergj Fishta i madh thoshte: "Zoti i qiell na mbi tokë, megjithëkënd vëllazin e shok, po gjithësekush në cakt vetë." Po, nuk shkuam në cakun tonë, kuptimin e vërtetë të fjalës, që pylli i Gjorgozit është i Malakastrës. Po pse është ai pylli i Gjorgozit? Është për të çarë drasa që kur të vdesim, të marrim drasat aty, gjithë krahinën e Malakastrës. Po, moqe, pyllin e Gjorgozit nuk është, nuk kemi në rregull. Po, moqe, një burim që ka shërbyer komunitetit, nuk kemi në rregull. Malakastra sot nuk e ka naftën. Rafinerinë do të thoshja, por naftën e ka aty. Ballshja është aty, Visoka është aty, vendburimet e saj janë të jashtëzakonshme, Gorishti përtej e tjera. Nuk e ka sot, do ta ketë nesër moderne

rafinerinë, por po mendove që meqë nuk ka rafinerinë sot, edhe ai ta heqim, sepse u zvogëlua forca e kësaj bashkie, kjo do të ishte vetëvrasje, jo vetëm për gjithë atë komunitet, por do ta bënim në kuptimin e vërtetë të fjalës invalide, gjithë, gjithë atë krahinë. Sikurse nuk mund ta largosh, ta largosh Byllisin, Nikean e të tjera, qytetërimin e lashtë ilir nga Ballshi, aty ku është, nga ajo qendër, pra e bashkisë, aty ku është, por përkundrazi duhet ta fuqizojmë, në rast se do të flasësh për turizëm historik, edhe që të dynden, sikurse faktikisht kanë filluar të dynden. Faleminderit.

#### **Valbona Karakaci:**

Faleminderit. Inkurajojmë, ë, qoftë zonjën, qoftë shoqatën që t'i depozitojë pranë parlamentit idetë në formë më të zgjeruar përmes platformës. Zonja Alkeida atje dhe zotëria, nëse jeni nga Lushnja, se duam të dëgjojmë edhe zëra nga Lushnja, apo zonja? Ja, menjëherë zotëria, pastaj po.

#### **Alketa Lugaj:**

Alketa Lugaj, ish-anëtare e Këshillit të Bashkisë Fier në periudhën 2015-2019. Në fakt, mandati ynë si këshilltar përkon me implementimin për herë të parë të kësaj reforme territoriale. Ajo që mbaj mend unë është kryeargumenti që përdori qeveria dhe partia që e bëri dhe e implementoi këtë reformë, që lidhet me faktin që tashmë do ketë vetëm qytetarë të Republikës së Shqipërisë, qytetarë të bashkive. Ndërkohë që është shumë mikluese të quash të gjithë qytetarë, patjetër, pavarësisht zonës ku banojnë, është sepse është e drejtë e shtetasve shqiptarë që për të gjitha taksat, tarifat, të marrin shërbime të barabarta dhe investime po të barabarta sipas specifikave të zonave. Por shumë shpejt do të shikonim që kjo do të ngelej vetëm një iluzion, sepse ë, ne do dallonim shumë shpejt që ka vetëm do të kishte shumë shpejt qytetarë të dorës së parë dhe të dorës së dytë. Qyteti i Fierit për bashkinë tonë do të bëhej poli që do të thithte investimet, njëkohësisht edhe do të merrte shërbime më të shumta në këmbim të taksave dhe tarifave, dhe njësitë e tjera administrative do ta ndienin veten qytetarë të dorës së dytë për shkak të mungesës së investimeve të shërbimeve që pak nga pak po ulej cilësia, madje dhe po mungonin. Pse e them këtë? Në shumë njësi administrative, në fshatra të ndryshme, për shkak edhe të shpopullimit që është një plagë e Shqipërisë në këto 10 vitet e fundit, ë, filluan të mbylleshin shkolla, qendra shëndetësore. Po flas vetëm për shkollat, meqënëse e njoh më mirë si fushë, ë, vetëm në këtë periudhë janë mbyllur 15 shkolla, dy gjimnaze dhe të tjerat nëntëvjeçare dhe shkolla varëse. Ndërkohë që janë në mbyllje për shkak se janë kthyer në shkolla varëse, rreth 11 shkolla të tjera, 26 shkolla që janë mbyllur apo rrezikojnë të mbyllën për një bashki, janë shumë. Është një qertur i mbyllur në ç'kuptim? Zbrazen zonat, mbyllën shkollat, aty mohohen shërbimet arsimore dhe më tej. Më kujtohet në vitin 2018, në Këshillin e Bashkisë, kam ngritur problemin e gjimnazit të Levanit për ta konkretizuar. Shkolla Kudbi Vruzha u shpërngul në Fier me premtimin se brenda një viti apo dy do të investojë për godinën e asaj shkolle në Levan. Kaluan shtatë vjet dhe nxënësit e Levanit endeshin në ambientet e dy gjimnazeve të Fierit. Vetëm një vit më pas, më para, këta nxënës u rikthyen në Levan, por tashmë në një shkollë të mesme të bashkuar që kuptohet nuk i ka standardet arsimore të njëjta me gjimnazet e mirëfillta. Ëh, tjetër do të kujtoj Libovshën, një nga zonat më arsimdashëse në bashkinë e Fierit. Është mbyllur gjimnazi, është kthyer në shkollë varëse dhe shumë e shumë unë e kam listën e shkollave të mbyllura dhe që janë në mbyllje, nuk po i përmend edhe për shkak të kohës. Pyetja ime që lind është: nëse do të kishim bashki në Levan me kryetarë të zgjedhur, do të mbahej premtimi për investim të shkollave? Do të mbylleshin këto shkolla në Levan, në Libovshë e të tjerë? Mendoj se jo. Do ta mbyll. Ëh, do t'i bashkangjitem

propozimit edhe të Ladit edhe të të tjerëve. Ka nevojë kjo reformë të rishikohet për të çuar shërbimet sa më afër qytetarëve. Është mundësia për bashkinë e Cakranit, një nga zonat më me ndikim, qoftë edhe gjeografik, qoftë shoqëror. Pse ta themi dhe jo, dhe politik që u intereson politikanëve? Është Levani, është Libovsha e të tjerë. Faleminderit për mundësinë që më datë. Suksese. Faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Po, zotëria. Po, dhe pastaj zotëria.

**Lirin Çela:**

Përshëndetje të gjithëve. Quhem Lirin Çela, pensionist nga Lushnja, por më duket se këtu paska qenë kanë mbledhur disa njerëz vetëm për t'u penduar, apo për diçka, dhe për hallet e tyre personaleve. Më sot, lutem, mua kjo reformë që është aktualisht, flas për në Lushnje, jam në periferi të Lushnjes, kam gjetur zgjidhje dhe më duket të flasin dhe lushnjarë të tjerë që çdo gjë nuk shkojnë direkt te titullari. Ne shkojmë direkt te njëësia administrative dhe aty e i shkon të gjitha, dhe më duket shumë me sukses për mua si person. Nuk flas në emër të njëjtit, apo të tjerit, kurse do ta mbyll vetëm me diçka për ofendimet e X-it. Po besoj se hajdut më i madh se ai avokat i atij s'do ketë në Shqipëri. Ju faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Po, zotëria, zotëria, ju lutem. Po, okej. Mirë, meqënëse e keni mikrofonin.

**Maksim Goga:**

Po, Maksim Goga, nënkryetar i Bashkisë së Rruskovecit. Unë dua t'u bëj dy pyetje ekspertëve që keni aty, me qëllim që të regjistrohen. E para, janë bërë 11 reforma administrative në territorin e Republikës së Shqipërisë, pak a shumë, në gjitha vitet. A ka një performancë historike të këtyre? Kush janë të mirat dhe të këqijat e njerëzve, apo të jetë së reformë? Nëpërmjet kësaj do nxjerr reformën e fundit të 2015-s. Në 2015-ën ne kemi qenë në komisione për një reformë territoriale administrative, e cila është sot në fuqi. Kjo reformë pati të mirat dhe të këqijat e veta. Në qoftë se të mirat e kësaj reforme janë ekzistuese për ato bashki që ekzistojnë, që kanë një performancë të mirë financiare, dy performancë të mirë në shërbim të qytetarëve, le të qëndrojnë, s'ka asgjë të keqe. Ato bashki që nuk kanë performancë dhe që nuk kanë performancë ekonomike, nuk u shërbejnë dot qytetarëve, nuk kanë staf, nuk kanë staf për menaxhimin e gjithë punëve të bashkisë, shumë mirë, në bazë të kësaj përvoje, besoj se vazhdon puna juaj si komision deri në përgatitjen e raportit përfundimtar, që unë do të thosha të jetë një raport sa më i suksesshëm nga ana juaj, me qëllim që të shërbejë komunitetit dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet kësaj i ktheva dhe përgjigje zotit Kujtim që thotë Rruskoveci: "Rruskoveci ka performancë të mirë, ka shërbime të mira ndaj qytetarëve, ndaj banorëve, ka ndërtoar rreth 300 hektarë me sera nëpërmjet lumit Seman me furnizim me ujë të pijshëm e të tjera, e të tjera. Sot është investim i qeverisë shqiptare, jo i bashkisë. Këtë jam koshent që stacioni i matkës për të furnizuar me ujë vaditje Rruskovecin, Vilmishin dhe deri në Fier vihet në efikasitet këto ditë. Faleminderit të gjithëve.

**Valbona Karakaci:**

Faleminderit dhe për ta përmbyllur këtë sesion të parë që në fakt lidhej me qeverisjen dhe territorin, por që natyrshëm kaloi edhe në argumente të tjerë, do t'ju ftoja që në këtë sesion të dytë të fokusohemi tek shërbimet publike dhe funksionet e bashkive. Ëh, në këtë pikëpamje do ju lutesha që të ishit sa më specifik për ato shërbime të cilat janë përmirësuar, apo ato shërbime që kanë nevojë të përmirësohen dhe cilat do të ishin modelet e duhura për t'i bërë shërbimet më funksionale për qytetarët. Bie fjala, ne kemi modelin e decentralizuar, atë të ujitjes, vaditjes. Këtu ka një numër të konsiderueshëm bashkish rurale. A ka funksionuar ky model? Por kemi edhe tendenca të tjera, siç ishte, siç është shërbimi i ujit të pijshëm, i cili është rimarrë nga qeveria. Nëse mund të jemi më specifikë për shërbime specifike, do ta ndihmonit komisionin që të modelojë qeverisjen e duhur? Po, zoti Beqiri, po, ju lutem.

### **Jaku Beqiri:**

Përsëritje të gjithëve. Quhem Jaku Beqiri, njësi administrative Koloni Lushnja. Ish-kryetar i saj, kësaj komune. Faktit që jemi sot këtu për reformën territoriale tregon që reforma territoriale e miratuar në 2014 ka dështuar, sepse prania juaj këtu dhe rimarrja edhe njëherë e kësaj procedure tregon që tek reforma e mëparshme diçka ka ceduar. Ka ceduar sepse janë shkelur dhe nuk janë respektuar disa kriteret të cilët zonja i di më mirë sesa unë. Dhe meqënëse ndihma e suedezëve dhe e zviceranëve që janë nga prapë pranë jush, kur e kam pyetur përfaqësuesin e Suedisë, po ju e keni bërë reformën në Suedi territoriale? Ka 34 vjet që ka nisur, tha, dhe akoma s'e kemi mbaruar, që do të thotë që reforma territoriale është shumë e vështirë. Që duan respektuar shumë gjëra, shumë kriteret të cilat në 2014, me miratimin e reformës aktuale, janë shkelur. Këtu bëhet krahasimi jo me ish 307 komunat, por bëjmë krahasimin me reformën e miratuar dhe cila ka qenë performanca e saj. Unë do t'i bie shkurt që reforma administrative e miratuar në 2014 ka rritur koston e shërbimit ndaj qytetarëve, sepse kjo nuk është as për faj të këtyre kryetarëve që janë aktualisht, por për shkak të distancave që qytetari përshkruan për të ardhur për të marrë shërbimin pranë bashkisë, e cila nuk e afron siç është afuar më përpara në njësi administrative. Sepse zotënia tha që kemi njësi administrative dhe unë atje marr shërbimin. Jo, atje shkon bën kërkesën dhe pastaj, kur të vijë grupi i punës, përgjigje e njëra-tjetrën, do të marrësh rezultatin që t'i pret përgjigjen e ankesës tate. Unë do të thoja që reforma e re që ne kemi nisur të bëjmë së bashku do të dëshiroja që të standardizonte shërbimin ndaj qytetarit, që edhe qytetari i qendrës së Fierit të ketë të njëjtin standard shërbimi si ai i Vanajt, që ndoshta kryetari i Fierit nuk e di, apo ai i qytetit të Lushnjes, me atë të fshatit Bitaj, të kenë një standard shërbimi, gjë e cila sot mungon. Ëh, një diçka tjetër që ne duhet ta mbajmë parasysh: rrethin, bashkia Lushnja ka afërsisht 200.000 banorë dhe është një bashki, dhe është ndër bashkitë më të mëdha: Fieri, Lushnja, Elbasani, apo ndonjë tjetër që s'më kujtohet. Kur ndërkohë ne në reformën e parë bëmë edhe bashki me 10.000, po dhe me 3.000, siç është Pusteci. Vendet ku ne duam të shkojmë në Evropë kanë një ndarje edhe më të madhe sesa ne. Në Francë, për shembull, janë 35.000 komuna. Çekia me 10 milion, me 10 milion banorë ka 6.000 komuna, që i bie 16.000, 16.000 banorë për komunë. Duhet ta përbëjmë. Ne kemi 200.000. Po, ju lutem, përbëjmë. Prandaj unë kërkoj që rrethi ose bashkia Lushnje të ndahet, të paktën, të paktën në katër njësi. Okej, faleminderit.

### **Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit. Ëh, do ju lutesha që të jemi të fokusuar tek sesioni që lidhet me shërbimet publike. Zotëria dhe pastaj zotëria, ju lutem. Ju lutem, meqënëse kemi një urbanist. Po, nesër. Faleminderit për fjalën.

**Elis Baba:**

Ëh, dhe pikë së pari, ë, mua më vjen mirë që bëhet kjo dëgjesa publike, sepse jam ndër ata. Unë jam, së pari, quhem Elis Baba, arkitekt urbanist, dhe dëgjesa publike duhet të ishin një ndër elementët kryesorë kur fillon planifikimi kaq i rëndësishëm. Për fat të keq, në Shqipëri këto zakonisht janë show, janë fars, dhe unë kam frikë se edhe kjo e sotshmja mund të rezultojë diçka e tillë. Duke parë edhe orientimin kur merret fjala dhe vuajtja për ta marrë këtë fjalë në shkretë, do të doja shumë që këtu të kishte më shumë ekspertë, më shumë profesionistë, ata që në realitet janë personat më të aftë për ta bërë këtë reformë, dhe t'u dëgjojmë më tepër fjalët e tyre. Unë shikoj aty në podium që ka dhe emra ekspertësh, dhe uroj që ata të kenë një farë lirie në shprehjen e tyre profesionale në atë që ata kryejnë. Ëh, por nuk po zgjatem shumë, po hyj te tema. Atëherë, ë, përsa i përket reformës territoriale, ë, pikë së pari, ne të gjithë jemi mbledhur për të diskutuar pikërisht për territorin, dhe territori shqiptar në ë 30 vite duket sikur i ka arritur skadencën, datë e skadencës, dhe qeverisja ka vendosur që ta konsumojë këtë sa më parë, sepse i ka ardhur data e skadencës dhe duhet të konsumohet. Në mijëra vjet nuk është konsumuar kaq territor shqiptar sa në këto 30 vite, dhe qeverisja dhe politika territoriale nuk po bëjnë asgjë më tepër sesa bëjnë një show dhe vazhdojnë të njëjtën strategji. E vetmja strategji që unë shikoj në terma afatgjatë, sepse ju folët, ë, politikanët aty folën për ë perspektivat për t'u futur në Evropë në 2029-ën. Ëh, u tha që planifikimi territorial patjetër është një një plan që mendohet për 20 vjet, për 50 vitet e ardhshme, por si mund të mendohet për këto 50 vitet e ardhshme, ë, kur ne ë bëjmë marrëveshje ë për t'u futur në Evropë, ë, ku ë kërkohet dekarbonizimi, ë, ku kërkohet energjia e pastër? Shqipëria i firmos. Shqipëria është një vend që ka fat për diell, për resurset hidrike, dhe aktualisht i ka rreth 90% të energjisë së pastër, por ndërkohë nënshkruan jep leje për TEC fosil në zonën e Fierit, në një zonë agrikulture, në Toskanën, siç e quan kryeministri, dhe për energji e cila do t'i shkojë Greqisë, një vendi të BE-së ku nuk lejohen më ndërtimi i TEC-eve fosile. Dhe ndërkohë, vetëm dy ditë më parë, nuk e di sa ka, ë, ka firmosur për gazifikimin një kontratë marramendëse miliarda, ë, për të përdorur gazin në Shqipëri. Përse do vejë ky gaz?

**Valbona Karakaci:**

Fokusohemi tek shërbimet vendore.

**Elis Baba:**

Patjetër, ky është një plan afatgjatë. Atëherë, në qoftë se ne thamë, ë, kolegu juaj tha që ë Evropa ka vënë në qendër mjedisin, patjetër, dhe kjo ka të bëjë me mjedisin. Ne duhet të shfrytëzojmë resurset që kemi në diell, në erë, dhe s'kemi pse të orientohemi ne në në resurset fosile. Pra, nuk ka sens. Ku është strategjia afatgjatë këtu? E vetmja strategji afatgjatë që kemi parë nga qeverisja në këto vite ka qenë, ë, t'i shpopullojmë Shqipërinë duke i krijuar mundësi dhe dalim dhe keqargufier në rajonin e Fierit që po flasim. Duke e shpopulluar, alternativa që jepet qytetarëve të Fierit u jepet ose largohen nga Shqipëria, ose largohen dhe shkojnë në Tiranë. Dhe kjo ka të bëjë me një diçka tjetër. Ë Evropa ju kërkon që për të bërë efizente, pra u fol për dimensionin, dimensionin që qeverisja vendore të jetë efizente, duhet të ketë një dimension. Sot, aktualisht,

këtë dimension e ka vetëm zona e Tiranës, metropoli. Duke e centralizuar ajo që po bëhet në tërë këto vite, çdo gjë po shkon në Tiranë, duke i centralizuar dhe politikat tuaja këtë gjë bëjnë. Vazhdojnë t'i çojnë ata që mbijetojnë në Shqipëri ovet në Tiranë, ose nuk mbijetojnë. Politikat që ju kërkon Evropa ju thotë decentralizim. Qarku i Fierit, rajoni i Jugut, mund të jetë nesër do do strategji afatgjatë që territori të ketë një menaxhim rajonal dhe duke marrë ë edhe në rregull e përmbledh e përmbledh dhe duke marrë dhe dy pika kryesore. U fol dhe për shërbimet për administratën, për personat që do ta kryejnë këtë punë. Nuk mund të ketë asnjë reformë që të funksionojë në terma afatgjatë. Një, në qoftë se nuk hiqet, nuk kontrollohet dhe partitë të kenë të hiqet financimi i tyre nga ë persona nga oligarkë dhe të kenë kontrollin e partive, sepse partitë janë ato që japin zanafillën e shtetit. Tjetra, fundit, sepse ekspertët, ekspertët nuk duhen të jenë të të politizuar. Ata ekspertët janë aty dhe ata që bëjnë reformën territoriale nuk duhet të kenë ndikim nga politika. Kështu, reforma territoriale do të ketë sukses dhe e fundit, e fundit, jo,

**Valbona Karakaci:**

E fundit e kemi përmbyllur. Ju lutem, e kemi përmbyllur. Ju faleminderit.

**Elis Baba:**

Uroj të dëgjoni sa më shumë profesionistë këtu, sepse kemi folur të gjithë. Po them të fundit, ju faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Duhet ta përmbyllim. Është pesë minuta.

**Elis Baba:**

Rajoni i Fierit po ju jap një sugjerim për afatgjatë. Sugjerimi për terma afatgjatë është që qarku i Fierit ka të vetmin bregdet të pashfrytëzuar akoma. Jo, kjo më duhet të jem korrekte me atë. Duhet të jetë një shembull i cili, i cili mund të bëhet një shembull suksesi i studiuar për t'i dhënë ekonomi të gjithë Fierit. Ju faleminderit. Jo t'i lihet vetëm dy personave ta shfrytëzojnë.

**Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit. Po, ja dhashë fjalën zotërisë atje që ja morën mikrofonin dhe pastaj një zonjë atje, një zonjë që të dhe po, zonja dhe zonja do doja. Po, ë, ju lutem, nëse kemi nga zërat që dëgjoj, ë, kam përshtypjen që Divjakën nuk e kemi dëgjuar, kështu që nëse ka përfaqësues nga Divjaka, okej, po, ju lutem, po.

**Kreshnik Dabi:**

Atëherë, të nderuar përfaqësues të komisionit, kolegë të këshillit bashkiak Fier, bashkëqytetarë dhe të pranishëm, emri im është Kreshnik Dabi, anëtar i kryesisë dhe këshillit bashkiak Fier, dhe kryetar qarku i Partisë Social Demokrate, pas-ardhës i një familje rezidente prej 100 vjetësh në qendër të qytetit të Fierit. Sot jemi këtu për të diskutuar mbylljen e një cikli 10-vjeçar të reformës administrative dhe nisjen e një kapitulli të ri. Por që të jemi të sinqertë, duhet të themi hapur se qytetarët nuk kanë nevojë për një hartë të re me ngjyra ndryshme. Qytetarët kanë nevojë për një bashki që ju përgjigjet, një administratë që jep llogari dhe një territor që mbrohet. Në emër të grupit që përfaqësoj dhe si zë i komunitetit, unë doja të theksoja që kjo reformë të bazohet të

paktën në pesë shtylla të panegociueshme si më poshtë: një, në autonominë financiare të njëësive të reja administrative që kjo reformë mund të prodhojë. Qarku i Fierit kontribuon në ekonominë kombëtare me naftën, industrinë elektrike, tregtinë, turizmin dhe bujqësinë e tij. Është e papranueshme që taksat e vjedhura në këtë tokë të udhëtojnë drejt Tiranës dhe të kthehen mbrapsht në formën e transfertave të kushtëzuara. Reforma duhet të sanksionojë që një përqindje substanciale e rentave, taksave industriale e të tregtisë, si dhe të ardhurave që gjenerohen nga aktiviteti bujqësor e turistik, të qëndrojnë drejtpërdrejt në arkën e bashkisë Fier. Ish-komunat, sot njësi administrative si Cakrani, Topoja, Libovsha, Mrostari, Porca apo Levani, nuk mund të jenë më aneks në thonjëza të qytetit. Çdo njësi duhet të ketë buxhetin e vet të dedikuar për shërbimet bazë, për kanalet kulluese dhe infrastrukturën rurale, pa pasur nevojë të presim me muaj të tërë për një firmë në qendër të qytetit. E dyta, ndryshime në ligjin 139/2015 ose miratimin e një ligji të ri, ku në thonjëza të kemi fundin e paprekshmërisë. Ligji aktual e ka kthyer kryetarin e bashkisë në një autoritet pothuajse absolut, ndërsa këshilli në një noter që thjesht vulos vendimet e tij. Kjo situatë është mirë të marrë fund. Ne propozojmë që ligji i ri t'i njohë këshillit bashkiak të drejtën e emocionit të mosbesimit nëse një kryetar dështon në performancë, nëse buxheti i investimeve mbetet në letër ose nëse shkeljet e auditimit janë sistematike. Këshilli duhet të ketë fuqinë ligjore me dy të tretat e votave të iniciojë shkarkimin dhe t'ia kalojë fjalën finale popullit përmes referendumit. Postet kyçe në administratë gjithashtu nuk mund të jenë më vetëm emërime politike. Çdo drejtor i shërbimeve publike, shërbimit social, urbanistikës, arsimit, taksave apo strehimit duhet të kalojë në seancë dëgjimore dhe konfirmim në këshill.

#### **Valbona Karakaci:**

Ju, ju faleminderit. 10 sekonda. 10 sekonda. Dhe dy pika. 10 sekonda.

#### **Kreshnik Dabi:**

Po, atëherë këtu, e nderuar zonjë, këtu ke 30 këshilltarë të këshillit bashkiak Fier, pjesë e të cilëve jam dhe unë, dhe jeni 100 m larg sallës së këshillit. Normalisht, shumë i bën që e morëm fjalën të gjithë dhe unë i dëgjova me shumë vëmendje, por duhet të na dëgjoni dhe ne. Unë përfaqësoj gjysmën e këshilltarëve këtu dhe dua, kam dhe dy pika, ta mbaroj dhe pastaj vazhdojmë.

#### **Valbona Karakaci:**

Do doja mirëkuptimin tuaj. Këtu kemi deputetë që përfaqësojnë mijëra qytetarë. Po flasim për qeverisjen e vendit. Kështu që do t'ju sugjeroja që t'ia dërgoni komisionit. Ju keni kodin dhe t'ia dërgoni me shkrim rekomandimet tuaja. Është fjalja e fundit. Po, jo, kam dhe dy pika. Mund t'i mbaroj. Ju lutem, përmbylleni.

#### **Kreshnik Dabi:**

Pika e tretë, mbrojtja e tokës dhe identiteti rural. Myzeqeja, si zemra e Shqipërisë, sot faktikisht glabrohet nga projekte industriale pa pasur asnjë filtër. Reforma territoriale duhet të vendosë një veto ligjore ku asnjë projekt industrial, asnjë landfill dhe asnjë ndërtim nuk mund të lejohet në toka bujqësore të kategorisë së parë dhe të dytë. Pika e katërt, transparenca dixhitale dhe penalitetet. Administrata aktuale vuan në thonjëza nga sëmundja e vonesës. Dokumentet dorëzohen me javë vonesë ose ka raste nuk dorëzohen fare. Ligji, më fal tamam, ligji duhet të parashikojë penalitete financiare të drejtpërdrejta për çdo drejtor që shkel afatet e transparencës. Kërkojmë gjithashtu

dixhitalizimin e plotë të inventarit të pronave të bashkisë. Transparenca e plotë është mbrojtja më e mirë kundër korrupsionit.

**Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit.

**Kreshnik Dabi:**

E pika e fundit, pika.

**Valbona Karakaci:**

Jo, do ta përmbyllim. Jo, ju lutem, do ta përmbyllim që të më lejoni edhe mua të jem korrekte. Do t'ju lutem, ë, komunikoni me komisionin, ë, veçanërisht të gjithë ato grupe interesi të cilat kanë përgatitur rekomandime për cilësinë e komisionit, do të konsiderohen me vëmendje. Dy zonja tani, zonja, do ja japim pak zonjave fjalën se po, ju lutem, dhe një zonjë atje në fund. Po, dhe zonja atje në fund. Dy zonja. Po. Dhe në vijim do donim edhe dikë nga Divjaka. Shpresoj që ndonjë nga zonjat të jetë nga Divjaka dhe zonja. Okej. Po, po, tre zonja. Tani do i respektojmë zonjat për paritet gjinor se unë kam edhe konflikt interesi. Po, ju lutem.

**Enkelejda Veliu:**

Atëherë, përshëndetje. Unë jam Enkelejda Veliu dhe jam mësuese në profesion. Pashë pak më parë këtu që folën disa njerëz, majtas dhe djathtas, dhe nga kjo ana kthejmë ata në duartrokitje. Me thënë të drejtën, ne nuk jemi në mbledhjen e PS-së këtu. Jemi, ë, për të dëgjuar ca gjëra që do na bëjnë mirë juve dhe neve bashkë. Pra, jemi për të nxjerrë ca problematika që do rregullojnë dhe do sistemojnë jetët tona. Një pyetje kam: ai uji që keni në shtëpi është i pishëm? Po, unë e blej për vete. Unë e blej. Kam vite që e blej. Kam vite që e blej. Tjetër gjë tani, për të folur për problemet që u ngrita. Fshatit ne i hoqëm komunat. Ë fakti që i kemi hequr komunat, i kemi hequr çdo lloj kompetence dhe të gjitha kompetencat i kanë kaluar qytetit. Ë mirëpo, jo rëndom, po dëgjojmë që edhe disa nga kompetencat më kryesore, siç është administrimi i taksave të qytetit dhe dhënia e lejeve, do të jepen pikërisht në Tiranë. Mos ndoshta kjo bëhet për të centralizuar pushtetin në një dorë të vetme? Jo. Dhe tjetër, për ta mbyllur, nuk të pyet aty. Dhe për ta mbyllur, ë, do doja shumë që ë Tirana zyrtare të mos fuste hundët gjatë gjithë kohës në zgjedhjen e kryetarëve të bashkisë, këshilltarëve dhe deputetëve. Jemi shumë burra dhe gra të mençur këtu që dimë të administrojmë dhe ta bëjmë qytetin tonë edhe më të mirë. Shumë faleminderit. Faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Zonja nga Divjaka dhe pastaj zonja në qendër. Zonja nga Divjaka dhe zonja në qendër. Po, atje. Po.

**Liri Biti:**

Të nderuar anëtarë të komisionit të postaçëm, të nderuar pjesëmarrës, Liri Biti, kryetare e këshillit bashkiak Divjak, në profesion mësuese. Gjatë kësaj kohe të reformës administrative, ne kemi vënë në re anë pozitive në bashkinë e Divjakës. Natyrisht, një prej pikave pozitive është emergjenca civile dhe ngritja e një stacioni për zjarrfikëset, të cilat i shërbejnë mbrojtjes së pronës

publike dhe private në kohë reale. Gjithashtu, një pikë tjetër është fuqizimi ekonomik nëpërmjet turizmit. Është ne shikojmë që kemi një investim në turizëm në zonën e Divjakës që i shërben jo vetëm komunitetit, por gjithashtu edhe turizmit në tërësi, ë duke bërë disa investime të rëndësishme. Në fakt, unë këtu do sugjeroja diçka në lidhje me menaxhimin publik të zonave. Me sa kam dëgjuar, bëhet nga ministria dhe duhet të centralizohet dhe t'i kalojë bashkisë për zonat ekonomike verore të përkohshme. Është në fakt, unë në bashkëpunim me gjithë anëtarët e këshillit bashkiak dhe të komunitetit, e duam Divjakën përsëri bashki, sepse qëllimi i kësaj është që të kemi shërbime sa më të mira. Faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Faleminderit. Po, zonja në qendër. Zonja në qendër. Po, ju lutem. Ja kalojmë pak, ju lutem, mikrofonin. Po.

**Laureta Salia:**

Përshëndetje. Unë jam Laureta Salia, juriste, përfaqësuese e bashkisë Malakastër. Ish-punonjëse e bashkisë Malakastër. E njoh shumë mirë administratën vendore, si dhe nga pozicioni që kam mbajtur në atë bashki. Kam qenë dhe ish-anëtare e këshillit bashkiak në legjislaturën 2015-2019. Unë dua të flas qartë dhe saktë pse bashkia e Malakastrës duhet të jetë ashtu siç është. Bashkia e Malakastrës i ka të gjitha kapacitetet e nevojshme për ta ushtruar shërbimin dhe funksionet e veta atje ku është, sa më pranë qytetarit. Parimi i subsidiaritetit, shërbimi afër qytetarëve. Gjithashtu, ka të gjitha kapacitetet njerëzore për të përthithur fonde e investime për shkak të pozitës gjeografike që ka bashkia e Malakastrës. Ka resurse të cilat janë për një turizëm modern, për një turizëm i cili. Nëse mund të fokusohemi tek shërbimet publike, ju lutem. Po, shërbimet publike kërkojnë që t'u jepen më tepër fuqizim njëësive administrative, të cilat ka tetë njësi administrative rurale dhe qyteti i Ballshit. Është tek shërbimet publike dua të përmend që të gjitha shërbimet janë të nevojshme të jenë atje afër qytetarit, të ushtrohen nga njësi të administrative, të fuqizohen kompetencat e njëësive administrative. Gjithashtu, dua të përmend dhe faktin që dhe funksionet e veta, të cilat bashkitë i kanë të sanksionuara me ligjin 139/2015, siç është funksioni i furnizimit me ujë të pishëm, kërkojnë që ky funksion të merret dhe të ushtrohet nga bashkia e Malakastrës. Gjithashtu, përmend që dhe shërbimet administrative sa më afër qytetarit janë më të nevojshme dhe janë efçente dhe cilësore, sepse jepen aty. Bashkia e Malakastrës është e hapur, marrin shërbim në një kohë shumë më të afërt dhe nuk është që duhet të presin, duhet të bëjnë rrugë për të marrë shërbim. Gjithashtu, dhe pjesa e njëësive administrative të marrin më tepër kompetenca për ushtrimin e funksioneve dhe të shërbimeve publike, si shërbimin e mbetjeve urbane, shërbimin e mirëmbajtjes së shkollave, etj. Faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit. Është kalojmë në dimensionin e tretë të diskutimit, atë që lidhet me financat vendore. Pa burime financiare, është e pamundur që të ofrohen shërbime publike cilësore. A janë të financuara sot funksionet e bashkive? A duhet të ndryshojë diçka në këtë drejtim? Tarifat dhe taksat, që natyrshëm edhe janë rritur, a janë përkthyer në shërbime më të mira për qytetarët? A mendoni se ka një skemë financimi e cila do të ndikonte në përmirësimin e shërbimeve publike? Është ju, ë, dhe meqënëse ma kanë kërkuar fjalën prej shumë kohësh, zoti Alike dhe zoti Kodeli. Po, ju lutem, zoti Alike.

**Gentian Alike:**

Përshëndetje. Gentian Alike, drejtori rajonal i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Fier. Do flisja për kryesisht për furnizimin e qyteteve ë me ujë. Ë ndryshimi ligjor i cili ka prekur kalimin e shoqërisë rajonale Ujësjetllës Kanalizime në llojin e kalimit të shoqërisë në varësi të Ministrisë së Infra Energjetikës, ë, dhe në varësi direkte të AKUK-ut, ka sjellë goxha ë përmirësim në furnizimin me ujë. Kryesisht në mënyrën se si ka operuar më përparë, në kohën kur ujësjetllësat menaxhoheshin nga ana e bashkive, në mënyrë të vazhdueshme ka pasur borxhe, ka pasur mungesë të furnizimit me ujë, dhe kjo aktualisht ka sjellë goxha përmirësim. Ë në periudhën e mëparshme kemi qenë diku në 13.6 orë furnizim me ujë, dhe aktualisht qyteti i Fierit furnizohet 24 orë. Pas marrjes në menaxhim, kemi, kemi, kemi përmirësim, kemi përmirësim ekonomikofinanciar të shoqërive, por çfarë më është më e rëndësishmja, që lidhet kryesisht me ë bashkitë, aktualisht taksat vendore të bashkisë përdoren nga bashkitë vetëm për nevojat e tyre dhe aspak për nevojat e ujësjetllësit. Ujësjetllësi është në menaxhim total të vetin, pa prekur ë taksat vendore dhe shpenzimet e bashkisë përdoren vetëm për nevojat e qytetarëve, pa ndërhyrë tek ujësjetllësi. Faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Faleminderit, Edvard. Po, po, ju lutem, Edvard. Po, ju lutem.

**Evdar Kodeli:**

Përshëndetje të gjithëve. Quhem Evdar Kodeli, ose siç më njohin fierakët Edi Kodeli, me profesion ekonomist, kontabilist, qytetar i bashkisë Fier. Meqënëse kam drejtorin e ujësjetllës kanalizimeve, di të them që një vërejtje tepër thelbësore ka zona brenda qytetit të Fierit që u bë investimi i ri i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe është turp i madh në shekullin e 21, 700 m nga bashkia Fier. Shumë qytetarë nuk u ofrohet shërbimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe këto janë investime gjysmake të bashkisë Fier, pasi bën diferencim të investimeve në bashki. Hidhemi tek tema, se edhe kjo ishte në kuadër të shërbimit të ujësjetllës kanalizimeve dhe të shërbimeve që përfitojnë qytetarët fierakë. Meqënëse ishim këtu, i them drejtorit, por edhe drejtuesit të bashkisë Fier, pasi që nga viti 2014 që u bë ë reforma e re, të cilën e kemi dhe sot, administrative territoriale, ka shumë zona dhe në kundërshtim edhe me zotin Dreka që foli në fillim, pasi kjo futet në shërbim të qytetarëve. Kanalizimet e ujërave të zeza ekzistojnë vetëm në 25% të bashkisë Fier dhe ky është një turp i madh për bashkinë që të flasim në shekullin e 21, vitin 2026, kur ka probleme për integrimin në Bashkimin Europian. Gjithashtu, kanalizimet e tokave, gjithashtu ë problematikat e kanaleve të vaditjes. Sfidoj kë të dojë të dalim dhe të shikojmë tokat 1.000 m nga zyrat e bashkisë Fier, se në ç'gjendje janë për t'u itur dhe kanalizimet e kullimit. Mos të cilësojmë që kemi kanalizimet sa kalojnë shinat e trenit në rrugën e Semanit, të bllokuara dhe të mbytëra. Ata që bëjnë, i sfidoj që të vijnë edhe ta verifikojmë. Jemi këtu të gjithë.

**Valbona Karakaci:**

Fokusohe mi te modeli i financimit. Si mund ta përmirësojmë modelin e financimit?

**Evdar Kodeli:**

Bashkia Fier, nga viti 2014 edhe sot që po flasim, taksat për individët janë pesëfishuar deri në 10fishuar. Gjithashtu, taksat për individët dhe për familjarët në vjeljen e detyrimeve tarifave

vendore janë minimalisht tre deri pesëfish më të larta dhe në proporcion me atë çfarë kanë përfituar qytetarët në rritjen e tyre ekonomike, është një barrë e madhe ekonomike sociale, rritja e këtyre taksave në disproporcion. Gjithashtu, shërbimet qytetarët fierakë apo edhe biznesi ë e kërkojnë në kohë reale, çfarë do të thotë që problematikat që ka biznesi duhet të gjejnë zgjidhje në kohën reale, pasi bashkia, në të kundërt, të bllokoi llogaritë dhe bllokimi i llogarive të çon në pezullimin e aktivitetit financiar.

**Valbona Karakaci:**

Ok, e përmbylim.

**Evdar Kodeli:**

Të lutem, sepse këto janë problematika të cilat, në krahasim me pagesat që bëjnë qytetarët, nuk u kthehet asgjë mbrapa. Gjithashtu, desha të theksoj që të gjitha ankesat që drejtohen në bashkinë Fier, vetëm 10% e tyre mund t'u kthehet përgjigje, pasi bashkia Fier është bërë një si një fortesë atomike, pasi çdo qytetar nuk ka mundësi, nuk ka mundësi anëtarët e këshillit bashkiak apo gazetarët që të futen në mbledhjen e këshillit bashkiak dhe jo më një qytetar i thjeshtë që të gjejë zgjidhje. Unë po flas si qytetar dhe jam i indinjuar kur po flas të tilla situata, sepse kemi shumë problematika të cilat i kemi adresuar te bashkia në mënyrë zyrtare nga të katra anët e bashkisë dhe nuk kemi marrë sot e kësaj dite përgjigje. Pra, në këto kushte, bashkia e madhe nuk mundet të kryejë këto shërbime dhe bashkia dhe shërbimi duhet t'i vejë te qytetari dhe jo qytetari të vijë te bashkia. Ju faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit. Ë rrjeti POP do ka qenë shumë aktiv në të gjitha dëgjejsat dhe unë të doja që, ju lutem, dhe përgatite të zoti Goga. Zoti Goga, atëherë ju falenderoj për thënien e fjalës.

**Nevila Jaha:**

Quhem Nevila Jahaj, drejtoj qendrën e Poka e Re dhe prej 22 viteve ne punojmë në terren me komunitete. Ë si pjesë e rrjetit POP, ok, si pjesë e rrjetit POP, unë po marr fjalën edhe për të dhënë edhe disa sugjerime që ne i kemi bërë si rrjet dhe do t'i vazhdojmë t'i themi dhe në 10, në të gjitha takimet që po bëhen në rang qarqesh. Ë nga monitorimi i shumëvjeçar që kemi bërë qeverisja vendore dhe nga monitorimi i kontratave sociale që ne kemi lidhur edhe me kandidatët dhe kryetarët e bashkive, ë mendojmë se sfidat kryesore të pushtetit vendor nuk lidhen thjesht me madhësinë apo numrin e bashkive, por me aksesin real të qytetarëve në shërbime, pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe ndjesitë e përfaqësimit të komunitetit. Reforma e vitit 2014 sollti konsolidim administrativ dhe rritje të kapaciteteve të shumë bashkive, por njëkohësisht dhe shumë zona rurale dhe periferike ka sjellë rritjen e distancës mes qytetarëve dhe institucioneve vendore. Dobësimi i rolit të njëësive administrative ka bërë që qytetarët të ndihen më pak të përfaqësuar dhe shumë prej tyre edhe mos të kenë informacion. Po ta kalojmë pak te taksa, se nuk dua të flas vetëm me pika. Ë shumë qytetarë sot nuk kanë informacionin e duhur nëpër bashkitë tona, sepse sot qytetari duhet të kishte këtë akses online. Faqet e bashkive duhet të ishin shumë herë më të prekshme nga qytetarët dhe të kishin informacione të updatuara, jo vetëm mbledhjet e këshillit bashkiak dhe të zbardhura ose çfarë vendimesh, por gjëja e parë duhet të ishte vendimmarrja për taksat. Ë një problematikë tjetër ë e dalë nga monitorimi që ne kemi bërë

si rrjet në të gjithë bashkitë e Shqipërisë. Ë investimet janë përqendruar kryesisht në zonat urbane dhe qendrat administrative dhe janë lënë pas fshatrat të thellë. Ë dhe ka cënuar kjo gjë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve vendore. Pra, që të rritet ky besim i qytetarëve, duhet të paktën llogaridhënia të jetë edhe në ato zona ë sa më të thella. Ë nuk dua të zgjatem shumë, por si fund dua të nxjerr pak edhe rolin e ë qytetarëve në marrjen e vendimeve të tyre të drejtpërdrejta. Ne mendojmë se referendumi vendor konsultativ duhet të konsiderohet si standard minimal për çdo ndryshim kufijsh territorial. Pra, e vendosim theksin te referendumi vendor, duke marrë dhe shembullin e Zvicrës dhe shumë shteteve të tjera, sepse vendimmarrësit duhet të jenë vetë qytetarët të cilët jetojnë në atë territor. Unë, si përfundim, them që sukcesi i reformës territoriale 2026 duhet të matet nga afërsia për të ofruar, nga aftësia për të ofruar vendimmarrje me qytetarët, për të reduktuar pabarazitë territoriale, për të garantuar shërbime cilësore dhe për të forcuar besimin e publikut te kjo qeverisje vendore.

### **Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit. Po, zoti Goga dhe pastaj zotëria që ma ka kërkuar. Po, po, zoti Goga dhe pastaj zotëria. Që t'i japim mundësi pak asaj anës atje, se nuk ka folur fare. Po, ju lutem.

### **Leksi Goga:**

Përsëritje të gjithëve. Jam Leksi Goga, lindur, rritur dhe banues në qytetin e Roskovecit. Ë e bëj këtë nisje të diskutimit për të referuar, për të referuar në tre kote ose në dy kote të ndryshme, për të cilat do përmbledh në tre temat që janë diskutuar deri tani. Në kohën para vitit '90 dhe pas vitit '90, ose dhe pas reformës administrative territoriale, para vitit '90, ë qyteti i Roskovecit ishte në varësi të komiteteve që ishte atëherë të rrethit të Fierit, që në kohët ne kemi qenë njerëz, domethënë kemi bashki, domethënë që në lokalitet që nuk preferoheshim nga rrethi i Fierit. Kishte mangësi të jashtëzakonshme në infrastrukturë, në investime, si në sporte, në terrene sportive, deri te konsumi ushqimor. Dhe gjëja e parë që mund të justifikoheshin atëherë pushtetit të pushtetit lokal ishin që kaq investime na lë rrethi, sepse na i merr ë Ballshi, që është qyteti i uzinës, Patosi, njëkohësisht edhe Fieri, që është qendra e madhe. Pas vitit '92 kaluam bashki më vete dhe fshatrat ishin në komuna. Aty, ë përveçse nuk ka pasur asnjë lloj investimi për në ndihmë të komunitetit, vetëm thjesht ishte ekzistonte si komunë. Pas vitit 2014 që u implementu dhe 2015 që u implementua ë reforma administrative territoriale, bashkia e Roskovecit u kapi një territor prej 118 km2 dhe me një popullsi prej 32.890 banorë, nga të cilët 18.000 janë rezidentë. Fuqia e bashkisë së Roskovecit sa filloi dhe po në financat po forcoheshin. Vetëm në vitin 2026 kemi një buxhet prej 715 milion e 315.000 lekë të rinj të përkthyer këtë në 7.5 milion euro, për të cilat në 53% kemi paga dhe sigurime shoqërore dhe në 32% po, po brenda kohës 32% kemi ë shpenzime kapitale të cilat janë përkthyer në rrugë, në rrugë edhe në investime të tjera në terrene sportive. Shërbimet e qytetarëve tani në bashkinë e Roskovecit, shërbimet ndaj qytetarëve janë më afër, sepse zyra me një ndalim ja mundëson të gjithë qytetarëve, të gjithë qytetarëve praninë ë te zyrat e te zyrat e ADISA-s si quhet ajo, te ë blerja e kartave të identitetit dhe pasaportave. Një gjë e mirë dhe investim që doli efikas ishte ishte që Roskovecit sot ka 24 orë ujë dhe në punët e tjera, si në në bordin e kullimit, ka një ndihmë të jashtëzakonshme nga drejtorja e bordit të kullimit dhe vetë, të cilët janë japin shërbim të gjithë qytetarëve. Ë prandaj, prandaj them që reforma administrative territoriale që bëhet në vitin që u prezantua në vitin 2015 ishte një nga reformat më të mira, të cilit i dha mundësi bashkisë së Roskovecit të bëjë investime dhe me të ardhurat e veta

në buxhet. Ju unë mendoj dhe të gjithë të tjerët mendojnë në Roskovec që bashkia të mbetet, që domethënë bashkia e Roskovecit të mbetet si bashki për vetëm një arsye, sepse financat i ka të plota dhe nuk ka borxhe ndaj të tregëve ose firmave të tjera që ekzistojnë. Ju faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit. Po, zotëria, zotëria, ju lutem, ngrihem në këmbë. Ë mos të ikun nga fillimi deri tani që po e përmbyllim atje në fund dhe pastaj Olsi këtu dhe ë do shkojmë drejt fundit. Jo, zotëria, fillimisht pastaj ju. Po, pra ne të ikim. Rrihet, rrihet.

**Unknow(nuk u prezantua):**

Tashti unë dy propozime kam. E para, e para do të dëgjoj këta ekspertët, po unë them kështu që bashkitë duhen bërë ë si mbas frymës, domethënë sa popullsi ka, se mund të bësh edhe një bashkitje me me 2.000 banorë, po nuk ia vlen. Ose e dyta, duhen shtuar komunat. A nuk e di se si duhet, domethënë ka disa forma, po e para është në bazë të frymës së popullsisë. Dhe e dyta, ne kemi ardhur këtu jo për të dëgjuar gjëra personale, e ka kryetari i bashkisë apo kush e ka. Kryetari i bashkisë sot ishte atje, në lagjen time, edhe po pastronte vlerat ai. Po pastronte plerat. Pse për këtë kemi ardhur ne? Ne kemi ardhur t'i japim një mendim për zotin Agron Haxhimi Ali, se tashti të bëhen 100 kështu bashki, sa deputetë do jenë vend 200, po rrogat e tyre, po celularët e tyre, po naftët e tyre. Prandaj t'i shikojmë çikë mirë, ose kush punon hanë, kush punon hanë e pinë. Faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Faleminderit edhe për atmosferën pozitive. Po, ju lutem.

**Endri Fejzullah:**

Përshëndetje të gjithëve. Të nderuar bashkëkryetarë të komisionit të posaçëm, deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, unë jam Endri Fejzullah nga qyteti i Patosit. Këtu fol shumë për të gjitha gjërat, veçanërisht për territorin, edhe për popullsinë u prek. Më lejoni t'ju them që popullsia nuk mund të ketë një relevancë determinuese në përcaktimin se cila bashki duhet të ekzistojë apo cila jo, sepse ajo Europa që ju proklamoni me të madhe, që edhe pak ditë më përpara ishte dita e deklaratës së Shumanit, dhe më lejoni t'ju them që Luksemburgu është një ndër vendet themeluese të Komitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, sot BE, që ka 12 kantone dhe 100 komuna. Pra, ideja nuk është tek popullsia. Ideja është te dekoncentrimi i pushtetit, fuqizimi i rolit të individit në komunitet dhe në vendimmarrjen publike, në mënyrë që mua po të ma heqësh bashkinë e Patosit, unë minimumi do ta përqendroj jetën ekonomike dhe sociale në Fier dhe maksimumi në Tiranë. Dhe këto vendbanime që ju i konstatuat, dhe këto vendbanime që ju konstatuat me të drejta se ka mungesë popullariteti, dikush edhe me nocion politik shpopullim e tjerë me radhë, duhet të ketë politika ripopulluese. Minimumi i politikës ripopulluese fillimi është që të ketë bashkinë ekzistenciale të vetë. Kritere të tjera, pra që popullsia nuk mund të jetë një kriter përcaktues, është edhe ekonomia aktive. Ka shumë bashki që kanë ekonomi aktive dhe një ndër to është po dal jashtë qarkut të Fierit, po është Ksamili. Ne mburremi me bumin ekonomik 10 milionë turistë, 12 milionë turistë, por nuk ia japim të drejtën atij komuniteti të vetë qeveriset të ketë autonomi vendore, të ketë mundësi ta marrë shërbimin sa më afër vetes, të mos shkojë në një në një bashki tjetër. Ka mundësi edhe për bashki të cilat kanë vlera

identitare, komunitare, historike dhe për kombin. Edhe për atë Cakranin që u zunë këtu, se mos u zini se mezi u kemi edhe nga të dyja palët, edhe për ata Cakranin që u zunë këtu, më lejoni t'ju përmend një shembull tjetër të Bashkimit Evropian. Është Sllovenia. Ka 20 bashki urbane dhe mbi 180 bashki rurale. Kështu i ka të emërtuara. Mos më dëgjoni mua. Hapi, lexoj, verifikoj dhe për të ardhur dhe tek thashë ekonomia aktive, por dhe tek potenciali ekonomik. Supozoj për Patosin nga i cili vij. Në qoftë se Patosi e ka potencialin ekonomik, ka fushën naftëmbajtëse, një subjekt që është ekonomikisht i pavarur, mund të jetë i pavarur për shumë çka, e jo më për autonomi vendore. Tani, për ta përmbyllur shkurtimisht, duhet që të ketë demokratizim dhe dekoncentrim i pushtetit. Edhe njëherë po e them për të fuqizuar rolin e individit që zoti Boçi dhe zoti Mazniku, kur të vijnë të më kërkojnë votën si këshill bashkiak, të mos më marrin votën si këshillin bashkiak dhe të marrin vendime në këshill qarku, pa ia dhënë kush këtë përfaqësim. Pra, ajo që konstatoj në fund, dhe për ta përmbyllur dhe me tre minuçin, është që reforma administrative territoriale duhet të udhëhiqet paralelisht edhe me reformën zgjedhore. E fundit dhe 10 sekondat, lutem. Edhe bashki të cilat nuk kanë mundësi të vetëadministrohen ekonomikisht, mund të kenë rëndësi për shumë nga gjërat që edhe po të përmend, meqënëse kam përveçse nga Patosi, kam edhe identitetin shqiptar i Çamërisë, po e përmend në të momentin që do heqësh konispolin, jo vetëm që do heqësh një bashki identitare, por duhet të fuqizosh edhe kufirin që është zonë kufitare dhe është e vetmja portë nëpërmjet së cilës ti i thua shtetasit të Greqisë mirë se vjen në Çamëri, dhe është e vetmja portë nëpërmjet së cilës i thua shtetasit shqiptar, mos harro Çamërinë. Pra, të gjitha këto duhet të funksionojnë vetëm në parime. Faleminderit dhe ndjesë nëse u zgjata. Shumë faleminderit.

#### **Valbona Karakaci:**

Po, ju lutem.

#### **Olsi Hamataj:**

Të nderuar drejtues dhe të nderuar pjesëmarrës, unë jam Olsi Hamataj nga njësi administrative Frakull. Jam fermer kultivoj luleshtrydhe dhe njëkohësisht eksportuesi më i madh në Shqipëri i luleshtrydheve shqiptare. Në vitin 2013 unë jam kthyer nga Greqia, pasi në Greqi kam studiuar, jam shkolluar dhe jam rritur, dhe kur jam kthyer, diskutimi dhe debati në thonjëza që e kam pasur me prindërit e mi ka qenë që ku do shkojmë, ku do kthehemi ne në Shqipëri, kur atje nuk ka as ujë nëpër toka, as kanalizime dhe as vaditje. Unë kam besuar shumë dhe e kam vendosur dhe jemi kthyer në Shqipëri si përfundim, dhe tashmë kemi arritur në njësinë administrative Frakull, kemi 200 hektarë sera luleshtrydhe të mbjella. Dhe si arritëm ne në 200 hektarë sera? Falë vëmendjes së bashkisë dhe Armandos, janë bërë të gjitha pastrimet e kanaleve kulluese, dhe për këtë nuk ka asnjëri dyshim këtu në të gjithë pranishmit. Dhe sot shkon ujë në të gjitha tokat dhe parcelat të cilat janë të mbjella. Këtë gjë unë jam shumë i sigurt që me të drejtë babai im thoshte do ishte e pamundur dhe e paarritur vetëm me mbështetjen e komunave, sepse unë jam i sigurt që komunat, edhe pagat e tyre, mezi i nxjerrin aty, jo më që të investojnë komunat dhe të na mbështesin ne. Diçka tjetër që është vënë re vitet e fundit është që është bërë investim edhe në ndriçim, edhe në rruga, dhe aktualisht po investohet dhe në ujësjellës. Por ditët e fundit, së fundmi, unë shikoj plot fermerë që vijnë tek pika e grumbullimit dhe janë të lumtur për faktin që po kalon energjia elektrike sipër parcelave të tyre, dhe të gjithë tashmë kanë mundësinë për të marrë energjinë elektrike. Këto janë disa gjëra për të për të thënë dhe për t'u kuptuar që kjo

reformë administrative është shumë efikase, dhe nëpërmjet kësaj reforme ne si njësi administrative mund të përfitojmë më tepër fonde dhe nga buxheti i shtetit dhe nga Bashkimi Evropian me projekte që mund t'i propozojë bashkia e Fierit. Dhe doja të jepja dhe një shembull të fundit. Kur jam kthyer nga Greqia, ka qenë koha e krizës në Greqi. Atëherë në Greqi kanë qenë rreth 1.000 e disa komuna. Sot atje janë rreth 300 komuna. Pse ndodhi kjo? Sepse ata ishin në krizë, dhe këtu unë nuk po flas as si socialist, as si demokrat, sepse ne kur shkojmë, kur shkojmë te toka, shkojmë dhe socialistët dhe demokratët. Duam energjinë elektrike, duam dritat, duam rrugën e shtruar me asfalt, duam ujin. Gjëja më e rëndësishme që jemi të bekuar që kemi ujin. Dhe siç ju thashë, Greqia i ka reduktuar komunat. Pse? Sepse kanë përforcuar bashkitë, dhe nëpërmjet bashkive ne mund të përfitojmë më tepër, dhe siç po ndodh në njësinë më punëtore të bashkisë së Fier në Frakull. Faleminderit.

### **Valbona Karakaci:**

Faleminderit. Duke ju kërkuar ndjesë të gjithë atyre që nuk arritën të komunikojnë, do duhet të shkojnë drejt përmbylljes së sesionit të tretë. Ju inkurajoj edhe në emër të komisionit, përdorni uebin e dedikuar për reformën territoriale. Ato zëra që nuk arritën të dëgjohen sot mund të komunikohen përmes këtij kanali të hapur. Në ndërkohë, ju informoj që ky takim është shfaqur drejtpërsëdrejti në kanalin e Kuvendit të Radiotelevizionit Shqiptar, por një përmbledhje të tij dhe njëkohësisht minutat e këtij takimi dhe rekomandime që dalin nga secili prej 12 takimeve mund t'i gjeni në faqen e dedikuar në uebin e parlamentit. Për ta përmbyllur, do doja t'ia kaloja fjalën për disa konkluzione të dy bashkëkryetarëve. Nga ana ime, faleminderit.

### **Arbjan Maznku:**

Të nderuar miq, jam mjaftësisht i privilegjuar që pata mundësinë të jem në këtë bisedë, ku padyshim të gjithë njerëzit kanë opinionin e tyre, dhe besoj se së pari jam i lumtur për faktin që po ia dalim me sukses. Ky është takimi i pestë në të cilin po bëjmë dëgjesa, ku secili njeri ka thënë mendimin e tij, e ka thënë siç e mendon. Jo dyrimisht neve do biem dakord me mendimin e çdo njeriu, por një vlerë thelbësore të qenurit pjesë të një komuniteti, të një qyteti, të një qarku, të një vendi është që kemi mundësi ta themi mendimin dhe më pas ta debatojmë, ta diskutojmë dhe të themi pastaj secili si e shikon dhe të ndikohemi sa mund të ndikohemi nga mendimi i njëritjetrit. Dhe kjo është një hap i madh përpara dhe besoj se është një hap i shëndetshëm për të bërë një zgjidhje më të qëndrueshme në kohë për mënyrën se si e strukturojmë dhe e ndërtojmë reformën. Së dyti, dëgjohe në mënyrë sistematike një element i cili është i kuptueshëm. Elementi identitar është një element që ka një rëndësi thelbësore në mënyrën se si ne e ndërtojmë komunitetet tona. Njerëzit të cilët ndjehen nga një krahinë, njerëzit që ndjehen nga një qytet, njerëzit që ndjehen nga një zonë, nga një qytet apo nga një territor i caktuar, e ndihmon shumë mundësinë që ata të bien dakord për rregullat përbashkëta, si menaxhojnë hapësirën, për mënyrën se si e pastrojnë qytetin, si mirëmbajnë varrezat, si mirëmbajnë shkollat, mënyrën se si jetojnë në një komunitet me njëritjetrin, kur ndajnë një identitet të caktuar. Por teksa kjo duhet të jetë një element padyshim thelbësor i çështjeve që marrim parasysh, duhet të marrim parasysh paralelisht dhe mundësinë praktike të njerëzve për ta qeverisur një territor të caktuar. Në mënyrë sistematike, njerëzit ngrejnë një çështje dhe thuhet: "Duam më shumë kompetenca." Kërkesë shumë e thjeshtë dhe shumë e natyrshme. Kompetencat kanë një problem: kërkojnë kompetencë, kërkojnë njerëz që mund t'i zbatojnë këto kompetenca. Kur ne flasim për të hartuar një plan

urbanistik, patjetër po na duhet që struktura të ketë urbanistë dhe arkitekt. Kur ne flasim për politikën e strehimit, duhet të kemi njerëz që mund t'i hartojnë një plan strehimi dhe ta zbatojnë një plan strehimi. Kur ne flasim për planet e zhvillimit infrastrukturor, na duhet të kemi inxhinierë. Ne flasim për menaxhimin e pyjeve, duhet të kemi inxhinierë pyjesh që dinë ta bëjnë planin e menaxhimit të pyjeve. Pra, raporti midis mënyrës se si një territor ndihet që i përket një zone të caktuar dhe mundësisë për të administruar më eficient këtë është një ndër temat që duhet ta diskutojmë në vijimësi për të gjetur një pikëprerje të qenësishme. Së dyti, flasim për financat, sepse të gjithë këto shërbime kushtojnë para. Për të ndërtuar rrugë, kushton para. Për të ndërtuar kanale kulluese, vaditëse, apo për t'i mirëmbajtur ato, kushton para. Dhe këto para do vijnë o nga taksat e banorëve, përfituesit e atij shërbimi, o nga paratë që vijnë nga taksat e përgjithshme që i gjithë vendi pagon, mbledhen në buxhetin e përgjithshëm dhe rikthehen në një zonë të caktuar. Sigurisht që kjo ka një element brenda që ca zona që s'ia dalin të kenë mjaftueshëm financa, duhet t'i ndihmojmë nga buxheti i madh i përgjithshëm. Disa shërbime duhet të pagohen nga të ardhurat që njerëzit kanë nga ajo zonë, dhe padyshim që duhet që të krijojmë një mekanizëm të barazisë së, ose më shumë se barazisë së, zhvillimit të përngjashëm, që mos kemi ca zona që janë pranë burimeve apo pranë zhvillimit që zhvillohen shumë shpejt dhe ca zona që zhvillohen më pak shpejt. Mënyrën se si e gjejmë këtë ekuilibër të financave është një debat i cili po merr gjithmonë e më shumë në çdo debat formë. Ç'pjesë të këtyre parave pagohen nga taksat, ç'pjesë vjen nga granti, dhe si gjehet ky ekuilibër? Sigurisht kemi një element të rëndësishëm tjetër: përfaqësimi. Njerëzit thonë: "Përfaqësohet fshati im në vendimmarrje, përfaqësohet qyteza ime, përfaqësohet krahina ime, përfaqësohet rajoni im." Në cilin nivel e gjejmë mekanizmin e përfaqësimit? Dhe shpeshherë njerëzit, u përmend dhe këtu sot nga një nga zonjat, shkojnë në një parim të rëndësishëm që quhet parimi i subsidiaritetit. Parim shumë i rëndësishëm. E Bashkimi Evropian është ndërtuar mbi këtë parim, i cili thotë: "Shërbimi duhet të shkojë sa më afër qytetarit." Por ky është vetëm pjesa e parë e fjalisë. Një pjesë të madhe të rasteve nuk e lexojnë pjesën e dytë ose nuk e kanë qejf ta thonë pjesën e dytë të parimit të subsidiaritetit, i cili thotë: "Sa më afër qytetarit, ku është e mundur t'i ofrohet shërbimi." Pra, ta çojmë afër, aq afër sa është e mundur të ofrohet shërbimi, se nëse e çojmë afër, po shërbimi s'është më e mundur të ofrohet, në atë moment si kemi çuar shërbimin afër? I kemi çuar një letër bosh pa mundësinë praktike që ai ta ofrojë shërbimin. Dhe kur flasim për subsidiaritetin, duhet të flasim për afrimin e shërbimit, por duhet ta flasim për mundësinë që shërbimi t'i ofrohet në mënyrë të prekshme dhe reale. Dhe së fundmi, për ta përmbledhur, duhet dhe të kuptojmë që ky, teksa është një mision vendor i përfaqësimit të, megjithëse u bë debati, të Cakranit apo të Roskovecit, që duhet të jenë debat shumë i rëndësishëm, sepse është ajo pjesa e parë që thashë e identitetit, duhet ta kuptojmë që është ndër të tjera dhe një mision kombëtar. 2027-ta mbyllen negociatat me Bashkimin Evropian. 2029-ta Shqipëria do të jetë një vend anëtar i Bashkimit Evropian. Në atë moment, secili prej nesh duhet të thotë popullit në mënyrë shumë popullorshme t'i shohi hajrin Bashkimit Evropian, dhe ajo lidhet me kapacitetin që do të ketë strukturat tona vendore për të planifikuar projekte, për të tërhequr fonde nga BE-ja, për t'i zbatuar këto fonde siç duhet dhe për të zhvilluar territorin, për të ndryshuar jetën e njerëzve, në mënyrë që BE-ja të mos jetë një premtim krenarie i të qenurit të barabartë në Bruksel, por të kthehet në mekanizma të prekshëm që ndryshojnë përditë jetën e secilit prej njerëzve në të gjithë territorin këtu. Dhe duhet të gjithë bashkë ta shohim dhe si një mision kombëtar, duke ruajtur sigurisht dhe identitetet specifike vendore. Faleminderit dhe do kemi dëgjesa tjera kur të kemi akoma më shumë produkte.

**Luciano Boci:**

Edhe unë dua t'ju falenderoj për mendimet. Në fakt, unë fier pak me tifozllëk politik në raport me dëgjesat e tjera, por brenda këtij tifozllëku u dhanë dhe shumë ide origjinale dhe që na ndihmojnë ne në punën tonë të komisionit. Duhet të jeni shumë të qartë: nuk ka Partia Demokratike një sfidë në raport me mazhorancën vetëm për çështjen e territorit. Jo, kjo reformë është funksionale, administrative dhe territoriale. Funksionale se ka të bëjë me funksionet e qartësuara që duhet të jenë të tilla, të shoqërohet me kompetenca në funksionet, të shoqërohet me autonomi financiare, të shoqërohet me përfaqësim, të shoqërohet me decentralizim dhe me demokraci. Por ama duhet të themi të vërtetën dhe ta shohim njëri-tjetrin në sy. Këto janë detyrat e qeverisë, jo të komisionit tonë, sepse qeveria ka shpallur dhe planin e saj strategjik 2023-2030 dhe përcakton qartazi që deri në vitin 2030 do i jepte pushtetit vendor të gjitha funksionet e qarta, të gjitha autonominë financiare, të gjitha kompetencat, të gjithë demokracinë e brendshme, por nuk e ka realizuar atë. Dhe ne s'mund të bëjmë një komision në bashkëpunim me opozitën për një detyrë që e ka qeveria, por nuk është vetëm reformë funksionale dhe ne biem dakord këtu si Parti Demokratike. Është administrative se prek strukturën e pushtetit vendor dhe duhet të shtojmë këtu edhe çështjen e qarqeve dhe të rajoneve që nuk u cek nga ata që u ngritën. Ne jemi për fuqizimin e nivelit të dytë të qeverisjes. Qarku është një element shumë i rëndësishëm i pushtetit vendor. Sot është i atrofizuar sepse nuk ka kompetenca, është thjesht administrativ, nuk është njësi financiare dhe duhet patjetër që të ketë autoritet, sepse qarku në funksionalitetin e tij mund të ndihmojë të gjitha ato bashki që, pavarësisht masës, kanë apo nuk kanë kapacitete administrative, kanë apo nuk kanë mundësi financiare, sepse është rregullator i të gjithë marrëdhënieve brenda marrëdhënies ndërbashkiake, e cila duhet të forcohet. Patjetër, në asnjë vend të Europës nuk kemi bashki të njëjta që bëjnë të gjitha funksionet, që kanë të gjitha kompetencat në mënyrë të barabartë. Kanë ndryshimet e tyre për shkak të territorit, popullsisë, largësisë nga qendra dhe të elementëve të tjerë, por është niveli i dytë ose është bashkëpunimi ndërbashkiak ai që e bën një gjë të tillë dhe Partia Demokratike, në këtë rast, është shumë e prirur që të forcojë qarqet ose t'i shndërrojë në rajone në një numër optimal, me qëllim që të realizohet ky bashkëveprim. Të vijmë tek territori. E përmenda në fillim, nuk është sfidë, nuk është se në qoftë se ne optimizojmë numrin e bashkive, pra shtojmë disa, Partia Demokratike ka fituar dhe përkundër, PS-ja ka humbur. Jo, ne na është hedhur një dorezë për shkak të alternativave të hedhura nga PS-ja që kërkon që bashkitë e vogla të absorbohen nga bashkitë e mëdha dhe këtu unë argumentat shumë të mira nuk do t'i marr nga ata që folën si përfaqësues të PD-së, por nga ata që folën si përfaqësues të PS-së, ata që mbrojtën Patosin, ata që mbrojtën Roskovecin dhe ata që mbrojtën dhe Konispolin, se edhe Konispolin e kemi trajtuar, ata që mbrojtën Malakastrën. Po, PD-ja është shumë e qartë, këto janë identitete të forta ekonomike, shpirtërore, historike, kulturore dhe që duhet të ruhen në ekzistencën e tyre. Madje, këto shtojnë argumentat tona, nuk ka rëndësi sa e madhe është bashkia. Këtu dëgjova që Patosi është shumë i suksesshëm, çka do të thotë që edhe bashkitë mesatare apo kuazi të vogla mund të jenë të suksesshme, se e thoni ju, e thoni ju, zyrtarët që drejtoni një bashki të tillë. S'ka rëndësi nëse është e madhe Malakastra, ajo duhet të ofrojë shërbime afër qytetarit, duke reflektuar dhe identitetin ekonomik, territorial, kulturor dhe historik. Dhe në këtë aspekt asnjë lloj konkurrence midis Cakranit, midis Roskovecit janë identitetet të pamohueshme dhe ne s'duhet të lejojmë absorbimin e tyre dhe madje duhet t'i shtojmë, sepse t'ju them një gjë: territori është një dimension shumë i rëndësishëm i karakterit, i personalitetit, i

formimit të njeriut, por edhe i zonave të caktuara dhe ka shumë ndryshime për shkak të territorit. Territori ndikon drejtpërdrejt në botëkuptimin e jetës së njeriut dhe heqja e këtij territori nga njeriu do të thotë të shkatërrosh një dimension të tij. Dhe provat që ju sillni tregojnë qartazi që ç'të keqe ka që ne të respektojmë këto identitete territoriale, që të shtojmë një numër të caktuar bashkish që ç'e kanë të domosdoshme se njerëzit i kërkojnë, i kërkojnë Elbasan, i kërkojnë Vlorë, i kërkojnë dhe këtu në Fier. Përndryshe, ne në qoftë se rrisim territorin e bashkisë, ne rrisim distancën, se këtu u fol për parametra europianë. Po, është e vërtetë, janë parametrat europianë, është interesi europian. Për çfarë? Për të zbatuar një standard shërbimi minimal kudo në Shqipëri. Ne paguajmë taksa njësoj edhe tarifa, ndriçim, gjelbërim, pastrim, por shërbimet ne i marrim ndryshe. Ndryshe unë qytetin tim, ndryshe ai që është Malakastër, ai tjetri që është më larg nuk i merr fare dhe ne duhet ta përcaktojmë se e do Europa. Po, duhet të përcaktojmë sipas standardeve të Europës një distancë, se themi është rritë distanca, nuk është virtuale vetëm distanca, është dhe virtuale, se është distancë shërbimi edhe distancë arritjes së qendrës së bashkisë. Bashkimi Evropian e ka 6-10 minuta, e zbërthyer në kilometra, 20-25 kilometra me shërbim urban. Jo, e kam thënë me makinë 120-norë, me makinën tonë kur ka rrugë të asfaltuar, se shumicën e rasteve pjesa rurale nuk ka as rrugën. Po, duhet edhe një standard europian për numrin e popullsisë, se u tha që popullsia nuk ka rëndësi, ka rëndësi dhe popullsia. Sot Bashkimi Evropian ka një mesatare për njësi vendore prej 6,000 banorësh. Sot Fieri e ka 40,000 banorë, po kaq pothuajse e kishte Vlora, Elbasani e kishte 60,000 banorë. Po pse duhet të ecim në parametra rritës kur ne me këtë numër banorësh në këtë sipërfaqe kemi probleme? Nuk e thotë opozita, e thonë raportet ndërkombëtare dhe raportet e institucioneve shqiptare. Ka diskriminim shërbimesh dhe jete brenda një bashkie të madhe dhe brenda territorit të Shqipërisë midis shumë bashkive. A po, duam ne të arrijmë standardet e Bashkimit Evropian? Po, në Fier ka një problem shumë të madh, për shembull që lidhet dhe me kompetencat që duhet të ketë pushteti lokal, kompetencat që lidhen me mbetjet. Në Fier sot ka një inxhinierator që ka glabruar 32 milionë euro. Ku është ai? Çfarë kompetence ka bashkia që ta fusë atë në punë? Nuk është kolauduar, se ja dimë historinë, s'ka asnjë lloj kompetence. Po ligji i ri i mbetjeve që doli, ja shtoi kompetencën bashkisë apo ja hoqi? Ja hoqi totalisht, po kështu ka ndodhur edhe me territorin, me planifikimin urban. Kështu ka ndodhur edhe me elementët e tjerë. Pra, paska pasur dhe ka një mungesë vullneti. Ne vullnetin nuk e kemi në dorë, se ne jemi pjesa e opozitës. Ne jemi në dakordësi që ky vullnet për t'i dhënë pushtetit lokal të gjitha këto drejta duhet të jetë i plotë dhe e mbështesim këtë gjë. Por ama, duke qenë se konsiderojmë kërkesat e komuniteteve të caktuara që janë insistuese, ne duhet të optimizojmë numrin e njësive vendore, sepse njësitë vendore forcohen, vetë rajonet që Europa i kërkon, sepse atë kërkon Europa. Nuk ka kushte për futje në BE për pushtetin vendor nga Europa fare. Unë jua përcaktova kolonat ku mbështeten ato. Vetëm në këtë rast të rajoneve po mund të realizohet më lehtë, më lehtë edhe thithja e fondeve të kohezionit apo fondeve të tjera, por edhe në situatën që ne jemi me bashkitë që kemi, ata mund të aplikojnë, sepse nuk varet nga masia e bashkisë. Kroacia ka 556 njësi vendore dhe ka marrë miliarda nga fondet e kohezionit. Po, duhen kapacitete administrative? Po, duhen, por kam një pyetje. Po mirë, të gjitha bashkitë kanë dyfishuar, trefishuar numrin e punonjësve. Çfarë kanë marrë këto? Çfarë kapacitetesh kanë marrë? Po mirë, ka një program akademia për trajnuar kapacitetet administrative? A ka funksionuar kjo akademia? S'po them për atë Akademinë e Barive, është akademi e specializuar e mbështetur edhe nga shoqata Bashkitë Forta. A ka funksionuar? Pra, këto kapacitete administrative duhen patjetër, por ka edhe një gjë, edhe në qoftë se nuk i kanë bashkitë e ndryshme, edhe në qoftë se nuk i kanë

kapacitetet, bashkëpunimi ndërbashkiak është thelbësor. Shumë projekte mund të realizohen në bashkëpunim me disa bashki, me një bashki tjetër. Shumë kompetenca mund të realizohen në bashkëpunim me shumë bashki tjera. Pra, ja dhe zgjidhja funksionale arrihet, ku ne japim dakordësinë tonë të plotë, por ama të konsiderojmë të gjitha ato që u parashtruan këtu dhe në takimet e tjera. Qytetarët duan një shtim optimal. Thashë, nuk është sfidë të rikthehemi tek 373-shi. Harrojeni, nuk e kërkon PD-ja. PD-ja kërkon të konsiderohet kërkesa e qytetarit, sepse do shërbime më shumë, do dhe një pushtet real, lokal, ku ai të përfaqësohet dhe ta ndiejë veten që është zot i territorit të tij, zot i vendit të tij. Faleminderit.

**Valbona Karakaci:**

Ju faleminderit për pjesëmarrjen. Ju lëmë takim në dëgjessën e rrallës ditën e premte në Shkodër. Ftohen përmes Radiotelevizionit Shqiptar të gjithë qytetarët, bashkohen në dëgjessën e rrallës ora 05:00 në Shkodër. Faleminderit.